

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7161
E premte, 12 prill 2024
Çmimi 0.50

Tahiri akuzon diplomacinë për dështim: Aleatët s'po e kërkojnë më nga Serbia njohjen e Kosovës | F. 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

"FREEDOM HOUSE (FH)" PUBLIKON RAPORTIN PËR NIVELIN E DEMOKRACISË NË DISA RAJONE TË EVROPËS DHE TË AZISË | F. 5

'REFUZIMI I SERBISË PËR TA NJOHUR KOSOVËN, SFIDË E MADHE NË DEMOKRATIZIM'



Organizata ndërkombëtare "Freedom House" ka publikuar raportin për nivelin e demokracisë në disa rajone të Evropës dhe të Azisë. Në këtë raport janë përfshirë edhe Kosova dhe Serbia. Sa iu përket këtyre dy shteteve, "Freedom House"

ka vlerësuar se refuzimi i Serbisë për ta njohur Kosovën mbetet sfidë e madhe në demokratizim. Po ashtu, kjo organizatë ka përmendur edhe sulmin në Banjskë dhe procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në raportin e "Freedom House" është

përmendur edhe reagimi i partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës ndaj "qasjes së ashpër të Albin Kurtit në negociatat me Beogradin dhe mungesa e konsultimeve me komunitetin e serbëve të Kosovës"

GJERMANIA IA DHURON FSK-së AUTOMJETET USHTARAKE 'RHEINMETALL'



ÇITAKU: QEVERIA E KOSOVËS PO I PËRÇAN SHOQIPTARËT NË MAQEDONINË E VERIUT



EKONOMI



BANKA BOTËRORE PARASHËH RITJE EKONOMIKE NË KOSOVË DHE NË RAJON

MURATI NJOFTON SE UA KA BARTUR KOMUNAVE 60 MILIONË EURO TË HYRA VETJAKE

SPORT

FFK-ja FILLON PILOT-PROJEKTIN PËR KRIJIMIN E LIGAVE U13 DHE U15 TË VAJZAVE

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky i lutet Perëndimit për kundërajrorë pas sulmeve të reja ruse

KIEV, 11 PRILL - Qindra mijëra ukrainas kanë mbetur pa rrymë si pasojë e një vale të re sulmesh të mëdha ajrore që Rusia kreu ndaj infrastrukturës së Ukrainës, duke e nxitur presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, t'i lutet përsëri Perëndimit që t'ia japë Kievit sistemet kundërajrore për të cilët ka aq shumë nevojë. Infrastruktura energjetike ishte caku kryesor i sulmeve raketore dhe me dronë nga Rusia në katër rajone ukrainase mëngjesin e së enjtes, ka thënë ministri i Energjisë i Ukrainës, Herman Halushchenko. "Sistemet e transmisionit dhe objektet e gjeneratorëve në rajonet Harkiv, Zaporizhja, Lviv dhe Kiev u sulmuan. Punonjësit e energjisë po

punojnë për t'i eliminuar pasojat", ka shkruar Halushchenko në "Facebook". Harkivi, qyteti i dytë më i madh i Ukrainës që ndodhet rreth 30 kilometra larg kufirit rus, ishte përsëri caku kryesor i sulmeve ruse mëngjesin e së enjtes. Zyrtarët lokalë raportuan për 10 sulme ajrore ruse në Harkiv. Si pasojë e këtyre sulmeve, më shumë se 200 000 qytetarë mbetën pa rrymë në Harkiv, ka thënë Oleksiy Kuleba, zëdhënësi i Presidencës ukrainase. "Deri tani nuk ka viktima. Informatat janë duke u përditësuar. Ne jemi duke i rregulluar prishjet në rrjetin energjetik", ka thënë shefi i administratës ushtarake në Harkiv, Oleh Synyehubov.



Kryetari i Harkivit, Ihor Terekhov, ka thënë se sulmet shkaktuan telashe në linjat e rrymës dhe në transport publik. Sulmet ruse në Harkiv janë rritur dukshëm javët e fundit. Terekhov tha së fundmi se raketave S-300 u nevojiten vetëm 40 sekonda për të arritur në Harkiv nga rajoni rus Belgorod. Ndërkohë, Zelensky ka thënë se

Rusia ka kryer sulme me shumë dronë dhe raketa, duke e dërrmuar sistemin kundërajror të Ukrainës. "Disa nga raketat dhe (dronët) Shahed u rrëzuan. Fatkeqësisht, vetëm një pjesë e tyre", ka shkruar Zelensky në "Telegram". Zelensky u ka bërë thirrje aleatëve të Ukrainës të veprojnë më shpejt dhe t'ia japin Ukrainës mjetet për ta mbrojtur veten. "Kemi nevojë për mbrojtje ajrore dhe mbrojtje të tjera, jo për shpërfillje dhe bisedime të gjata. Nëse Rusia lejohet të vazhdojë ta bëjë këtë, raketat ruse dhe 'Shaheds' nuk do ta sulmojnë vetëm Ukrainën, por edhe përkushtimin e partnerëve të saj. Kjo do të jetë licencë globale për terror", ka shkruar Zelensky. Një paketë me ndihmë amerikane

në vlerë prej 60 miliardë dollarësh ka ngecur në Dhomën e Përfaqësuesve që disa muaj, i bllokuar nga një numër i republikanëve, të cilët besojnë se çështjet e brendshme kanë përparësi, edhe pse Departamenti i Shtetit dhe Departamenti i Mbrojtjes po e shtynj Kongresin ta miratojë atë. Të mërkurën gjenerali i lartë amerikan në Evropë ka paralajmëruar se Ukraina nuk mund t'i bëjë ballë e vetme luftës kundër Rusisë. "Ukraina nuk mund t'i bëjë ballë e vetme kësaj lufte. Shtetet e Bashkuara, aleatët dhe partnerët tanë duhet të vazhdojnë t'i japin Ukrainës municion, armatim dhe materiale", ka thënë gjenerali Christopher Cavoli.

ShBA-ja i premtton Izraelit mbështetje të 'palëkundshme' kundër kërcënimeve nga Irani



WASHINGTON, 11 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, i ka premtuar Izraelit mbështetje të "palëkundshme" amerikane pas drujtjeve të vazhdueshme se Teherani mund të hakmerret për një sulm nga i cili u vranë dy gjeneralë të lartë iranianë. Bideni ka paralajmëruar e Irani po kërcënon ta kryejë një "sulm të madh", pas një sulmi kundër konsullatës iraniane në Siri para 10 ditëve, për të cilin Teherani e fajëson Izraelin. "Ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbrojtur sigurinë e Izraelit", ka thënë Bideni. Të mërkurën, lideri suprem i

Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, tha se sulmi i Izraelit në Damask ishte i barasvlershëm me një sulm kundër vetë Iranit. Një zyrtar iranian e paralajmëroi Izraelin se ambasadat e tij s'janë më të sigurta. "Kur ata e sulmuan zonën e konsullatës sonë ishte sikur të na e sulmonin territorin tonë. Regjimi i lig duhet të ndëshkohet, dhe do të ndëshkohet", ka thënë Ali Khamenei në një fjalim televiziv. "CBS News" ka raportuar më 5 prill se inteligjenca amerikane ka lënë të kuptohet se Teherani është duke planifikuar një sulm që do të përfshijë dronë "Shahed" dhe raketa lunduese. Nuk dihet caku e

as koha e sulmit të mundshëm, por goditja e një ndërtese diplomatike izraelite do të ishte përgjigje proporcionale, është thënë në raport. Bideni është zotuar ta mbështesë Izraelin, duke folur për gazetarë në Shtëpinë e Bardhë të mërkurën vonë, ku e ka pritur në takim kryeministrin japonez Fumio Kishida. "Siç i thashë kryeministrit (të Izraelit Benjamin) Netanyahu, përkushtimi ynë ndaj sigurisë së Izraelit kundër këtyre kërcënimeve nga Irani dhe përfaqësuesit e tij është i palëkundshëm. Më lejoni ta them prapë: i palëkundshëm", ka thënë Bideni.

Vriten tre djemtë e liderit të Hamasit nga një sulm izraelit në Gaza

GAZA, 11 PRILL - Tre djem të liderit politik të Hamasit – grupit të shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian – janë vrarë nga një sulm ajror izraelit në Rripin e Gazës të mërkurën. Hamasi ka thënë se në këtë sulm u vranë edhe katër nipër e mbesa të liderit të vet. Djemtë e Ismail Haniyeh janë në mesin e figurave të profilit më të lartë që janë vrarë deri tani në këtë luftë. Izraeli ka thënë se djemtë e tij ishin operativë të Hamasit, ndërsa Haniyeh e akuzoi Izraelin se veprroi "në frymën e hakmarrjes dhe vrasjes". Vrasja e tyre rrezikon të ndikojë në bisedimet e ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët për armëpushim në Gazë, të cilat filluan të shënojnë përparim në ditët e

fundit, pavarësisht se mes palëve ka ende goxha dallime në çështjet kryesore. Po ashtu, ata janë vrarë në një kohë kur Izraeli po përballet me trysni të madhe – posaçërisht nga aleati i vet kryesor, ShBA-ja, për ta ndryshuar mënyrën se si po e kryen luftën në Gazë, në veçanti kur bëhet fjalë për ndihmat humanitare për të cilat kanë aq shumë nevojë palestinezët. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka thënë se beson se kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, po bën "gabim" në mënyrën se si po e trajton Gazën. "Unë mendoj se kjo që po bën ai është gabim. Nuk jam dakord me qasjen e tij", ka thënë Bideni në një intervistë për "Univision" - një rrjet televiziv në gjuhën spanjolle. Haniyeh ka thënë se Hamasi nuk do të dorëzohet para trysnisë pas



sulmit kundër familjes së tij. "Armiku beson se, duke i sulmuar familjet e liderëve, do t'i shtyjë ata të heqin dorë nga kërkësat e popullit tonë. Kushdo që beson se sulmi ndaj djemve të mi do ta shtyjë Hamasin ta ndryshojë qëndrimin e vet, e gënjen veten",

ka thënë Haniyeh për "Al Jazeera". Izraeli ka thënë se djemtë e Haniyeh kanë kryer veprimtari militante në qendër të Rripit të Gazës, por nuk dha hollësi të tjera. Izraeli nuk ka komentuar fare për vrasjen e nipërve dhe mbesave të tij.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, është zotuar se do të arrijë "fitore të plotë" dhe se do t'ia shkatërrojë Hamasit aftësitë qeverisëse dhe ushtarake për ta parandaluar përsëritjen e sulmit të 7 tetorit. Izraeli e ka nisur luftën në Gazë si përgjigje për sulmin e Hamasit në jug të Izraelit, ku u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe u rrëmbyen 250 të tjerë, sipas autoriteteve izraelite. Më shumë se 33 400 palestinezë janë vrarë në luftimet e pashësura në Gazë, sipas zyrtarëve shëndetësorë në enklavën palestineze, të cilët nuk bëjnë dallim mes civilëve dhe luftëtarëve kur i llogarisin viktimat. Por, sipas tyre, shumica e të vrarëve janë gra dhe fëmijë. Izraeli thotë se i ka vrarë 12 000 militantë, por nuk ka dhënë dëshmi për këtë.

Quint-i i bën thirrje Listës Serbe dhe të tjerëve ta rishqyrtojnë bojkotimin e votimeve në veri

PRISHTINË, 11 PRILL - Përfaqësuesit e Quint-it dhe të Bashkimit Evropian në Kosovë kanë thënë të mërkurën se ndiejnë keqardhje për deklaratat e Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - dhe disa figurave të tjera politike serbe në Kosovë për tërheqje prej procesit zgjedhor që do të zhvillohet më 21 prill në komunat veriore të Kosovës për shkarkim ose jo të kryetarëve shqiptarë. Quint-it përbëhet prej Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë dhe Italisë.

Në reagim është thënë se edhe ndonjë zgjedhjet e prillit të vitit të kaluar nuk kanë ofruar zgjidhje politike afatgjatë, "bojkotimi i votimit më 21 prill nuk do të sjellë ndonjë përfitim për qytetarët që jetojnë në veri". "Prandaj ne i bëjmë thirrje Listës Serbe dhe tjerëve t'i rishqyrtojnë pozicionet e tyre".

Kryetarët shqiptarë i kanë marrë pozitë pas zgjedhjeve të mbajtura në prill të vitit të kaluar në procesin zgjedhor të bojkotuar prej Listës Serbe, e cila gëzon mbështetjen e

Beogradit zyrtar. Si pasojë e rritjes së tensioneve në veri dhe kërkesave të vazhdueshme të faktorit ndërkombëtar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, Qeveria e Kosovës e ka prezantuar në shtator të vitit të kaluar një udhëzim administrativ që parasheh largimin e një kryetari prej pozitës që ka. Ndonjë Lista Serbe pati marrë pjesë në hapat e parë në iniciativën e mbledhjes së nënshkrimeve për largimin e kryetarëve, ditë më parë ajo ka thënë se nuk do të marrë pjesë në votimin e caktuar në prill në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok për largim të kryetarëve atje.

Më 7 prill Lista Serbe, duke njoftuar se po tërhiqet nga procesi i zëvendësimit të kryetarëve në komunat në veri, ka thënë se procedurat e planifikuara janë "të pamundura" dhe se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, "ka bërë gjithçka që votimet të dështojnë". Më herët gjatë javës zyrtarë të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) kanë bërë me dije se anëtarët e Komisioneve Komunale



Zgjedhore (KKZ) prej Listës Serbe janë dorëhequr në katër komunat veriore me shumicë serbe, ndërsa anëtarë i Nismës Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë është dorëhequr në Mitrovicë të Veriut. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KKZ-të administrojnë zgjedhjet brenda komunës përkatëse nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së. Sipas KQZ-së, dy subjektet kanë afat deri më

11 prill, në orën 16:00, që t'i nominojnë emrat e rinj. "Na vjen keq për deklaratat e Listës Serbe dhe aktorëve të tjerë politikë serbë në Kosovë që bëjnë thirrje për tërheqje nga pjesëmarrja në votën për largim të kryetarit. Pjesëmarrja demokratike është kyçe për të garantuar që institucionet e zgjedhura janë përfaqësuese të popullatës së cilës i shërbejnë. Vota është liri themelore e shoqërive demokratike", është thënë në një

reagim publik të Quint-it. Përfaqësuesit e Quint-it i kanë bërë thirrje edhe Qeverisë së Kosovës t'u përgjigjet shqetësimeve të qytetarëve dhe të reagojnë me profesionalizëm përgjatë këtij procesi. Qeveria e Kosovës i ka bërë thirrje Listës Serbe të mos përhapë dezinformata dhe të mos u bëjë presion qytetarëve të komunitetit serb "që duan të jenë pjesë e procesit demokratik të 21 prillit".

KQZ-ja sqaron vendosjen e kamerave në vendvotime për votimin e 21 prillit në veri

PRISHTINË, 11 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka dhënë disa sqarime në lidhje me vendosjen e kamerave në vendvotime për votimin e 21 prillit, ku do të votohet për largimin e kryetarëve të katër komunave veriore.

KQZ-ja ka bërë me dije se ky nuk është një vendim që përfshin vetëm procesin e votimit më 21 prill. Përmes një njoftimi, ky institucion ka treguar se ky vendim do të vlejë për të gjitha proceset e ardhshme zgjedhore kurdo që ato do të mbahen.

"Lidhur me planifikimet për të vendosur kamera në vendvotime, KQZ sqaron se ky nuk është një vendim që përfshin vetëm procesin e votimit më 21 prill 2024, por do të vlejë për të gjitha proceset e ardhshme zgjedhore. Për këtë temë duhet të mbahen parasysh disa çështje. Së pari,



vendosja e kamerave në vendvotime është planifikuar gjatë hartimit të akteve nënligjore nga KQZ, më saktësisht me Rregulloret Zgjedhore Nr. 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve dhe Nr. 12/2024 për votimin, numërimin dhe menaxhimin e Vendvotimit. Këto dhe Rregulloret tjera

Zgjedhore nuk janë të hartuara vetëm për procesin e votimit që do të mbahet më 21 prill, por do të vlejë edhe për proceset e ardhshme zgjedhore", është thënë në njoftimin e KQZ-së. Më tutje, KQZ-ja ka sqaruar qëllimin e vendosjes së këtyre kamerave. "Së dyti, vendosja e

kamerave vëzhguese në hapësirat brenda vendvotimit bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë së materialeve zgjedhore dhe ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit në vendvotim. Sipas vlerësimeve të KQZ-së, në ditën e zgjedhjeve, në Qendra të Votimit, përkatësisht në Vendvotime, në proceset zgjedhore nga viti 2009 deri në vitin 2021 janë evidentuar parregullsi të cilat kanë ndikuar në integritetin, koston dhe besimin e publikut në zgjedhje. Në proceset zgjedhore 2009-2021 mesatarisht janë rinumëruar 36% e vendvotimeve dhe kjo ka ndikuar në rritjen e koston të zgjedhjeve dhe rënien e besimit të akterëve në administrimin e procesit zgjedhor", është thënë në njoftimin e KQZ-së, duke dhënë edhe sqarime të tjera. "Së treti, edhe sipas procedurës së miratuar nga KQZ-ja, është me

rëndësi të sqarojmë se vendosja e kamerave në vendvotime do të bëhet duke siguruar plotësisht fshehtësinë e votës, pasi ato do të vendosen në skajin tjetër të vendit ku do të jetë kabina e votimit dhe në asnjë rrethanë nuk do të mund të regjistrojë shënjimin e preferencës së votuesit. Së katërti, ruajtja e regjistrimeve të kamerave do të jetë e përkohshme, deri në shkatërrimin e materialit zgjedhor, që sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme bëhet brenda 60 ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve. Dhe, së fundmi, KQZ në ditën e votimit nuk do t'i monitorojë këto kamera, pra regjistrimi do të bëhet në mënyrë pasive. Në videoregjistrim mund të sigurohet qasje vetëm me vendim apo kërkesë të institucioneve ligjzbatuese: KQZ-së, PZAP-it, prokurorisë apo gjykatës dhe jo në rrethana tjera", ka njoftuar KQZ-ja.

Osmani dhe kryesuesi i OSBE-së diskutojnë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

Prishtinë, 11 prill - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim kryesuesin aktual të OSBE-së, Ian Borg, i cili është edhe ministër i Jashtëm i Maltës. Sipas njoftimit të Zyrës së Presidentes, në takim është diskutuar edhe për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. "Në takim është diskutuar edhe për raportet bilaterale midis Kosovës dhe Maltës, anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, si dhe për zhvillimet e fundit politike në rajon. Në diskutim me ministrin

Borg, presidentja ka thënë se Kosova vazhdon të jetë në ballë të progresit në rajon dhe më gjerë sa i përket forcimit të sundimit të ligjit dhe demokracisë si dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Në këtë frymë, Presidentja Osmani potencoi se anëtarësimi i Kosovës në institucionet euroatlantike do të ishte triumf për demokracinë dhe për të drejtat e njeriut jo vetëm në Kosovë, por në mbarë Evropën", ka njoftuar Presidenca e Kosovës.

Edhe ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka

pritur të enjten në takim kryesuesin e OSBE-së dhe ministrin e Jashtëm të Maltës, Ian Borg.

Bashkëpunimi në demokracizim, sundim të ligjit, liri të medieve, avancim të të drejtave të komuniteteve joshumicë dhe siguria në Kosovë dhe rajon ishin temat kyçe ndërmjet Gërvallës dhe Borgut. Gërvalla ka shprehur gatishmërinë e Republikës së Kosovës për fuqizimin e bashkëpunimit në projekte të reja, të cilat qëllim kanë demokracizimin, sigurinë dhe stabilitetin rajonal.





“Freedom House (FH)” publikon raportin për nivelin e demokracisë në disa rajone të Evropës dhe Azisë

‘Refuzimi i Serbisë për ta njohur Kosovën, sfidë e madhe në demokratizim’

Organizata ndërkombëtare “Freedom House” ka publikuar raportin për nivelin e demokracisë në disa rajone të Evropës dhe Azisë. Në këtë raport janë përfshirë edhe Kosova dhe Serbia. Sa iu përket këtyre dy shteteve, “Freedom House” ka vlerësuar se refuzimi i Serbisë për ta njohur Kosovën mbetet sfidë e madhe në demokratizim. Po ashtu, kjo organizatë ka përmendur edhe sulmin në Banjskë dhe procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në raportin e “Freedom House” është përmendur edhe reagimi i partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës ndaj “qasjes së ashpër të Albin Kurtit në negociatat me Beogradin dhe mungesa e konsultimeve me komunitetin e serbëve të Kosovës”

PRISHTINË, 11 PRILL - Pavarësisht një viti të turbullt për shoqërinë civile dhe qytetarët e Kosovës, pozita e këtij vendi në rrugën drejt demokratizimit ka mbetur e njëjtë me atë të vitit të kaluar, është thënë në raportin më të ri të organizatës ndërkombëtare “Freedom House” për nivelin e demokracisë në disa rajone të Evropës dhe Azisë. Problemet me Serbinë janë përmendur si ndër pengesat kyçe në rrugën e Kosovës përpara. Në vlerësimin për vitin 2023, prej 1 deri në 7 pikë, ku 1-shi paraqet nivelin më të ulët të përparimit demokratik dhe 7-ta më të lartit, Kosova vazhdon t’i ketë 3.29 pikë. Sa iu përket vendeve të rajonit, Shqipëria dhe Kroacia nuk kanë ndryshuar, po ashtu, pozitë, ndërsa Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina kanë shënuar rënie

në rrugën drejt demokratizimit. Përveç Kroacisë, vendet e tjera të Ballkanit janë në listën e vendeve me regjim hibrid të qeverisjes, sipas vlerësimeve të “Freedom House”, organizatës me seli në Uashington. Megjithatë, Kosova përmendet si vend me regjim hibrid të drejtuar kah demokracia, Serbia kah autokracia, ndërsa Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina si të përziera në të dyja anët.

Protestat në veri, incidenti në Banjskë, marrëdhëniet Kosovë - Serbi

Në pjesën për Kosovën, në raport përmendet se më 2023 mospajtimet me Serbinë kanë hyrë në një fazë të re të përshkallëzimit të tensioneve. “Protestuesit serbë të Kosovës

janë përlëshur dhe i kanë plagosur 30 trupa të NATO-s në maj, dhe serbë të armatosur kanë kryer sulm në shtator, në të cilin janë vrarë katër persona, përfshirë një zyrtar policor”, është thënë në raport.

Vlerësimi ka qenë referencë për protestat e majit në tri komunat në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - si shenjë kundërshtimi për hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale, si dhe për sulmin e shtatorit në Banjskë të Zveçanit, në të cilin është vrarë reshteri Afrim Bunjaku dhe në shkëmbim e sipër të zjarrit edhe tre sulmues serbë. Përgjegjësinë për sulmin e pati marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - Millan Radoiqi, i cili besohet se tani është në Serbi, dhe për të ekziston një fletarrestim

ndërkombëtar prej Agjencisë Ndërkombëtare të Policisë (INTERPOL). Kosova e ka fajësuar shtetin e Serbisë për organizim dhe kryerje të sulmit, mirëpo Beogradi zyrtar i hedh poshtë vazhdimisht akuzat. “Në shumë vende, por sidomos në ato të Ballkanit Perëndimor, liderët politikë po e shfrytëzojnë fokusin më të madh në sigurinë rajonale si arsye për t’i përmbysur institucionet demokratike dhe për t’i shmangur normat demokratike”, është thënë në raportin e “Freedom House”. Në raport është përmendur, po ashtu, se Qeveria e Kosovës, e cila e ka nisur udhëheqësinë më 2021, “është përpjekur ta largojë vendin prej trashëgimisë së konfliktit parlamentar, duke promovuar një agjendë reformash të bazuara në sundim të ligjit”. “Kryeministri Albin Kurti ka iniciuar proces të ri të vetingut për gjyqtarët, mirëpo refuzimi i Serbisë për ta njohur pavarësinë e Kosovës vazhdon të jetë barrierë e madhe për demokratizim. Pavarësisht prej marrëveshjeve të arritura mes dy qeverive në fillim të vitit 2023, vitin e kanë përcjellë jostabiliteti dhe përshkallëzimi i dhunës së nxitur pjesërisht prej lidhjeve jozyrtare të Beogradit me grupet e organizuara

kriminale”, është thënë në raport. Në shkurt të vitit 2023 Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve, ndërsa në mars për një aneks zbatim. Megjithatë, palët nuk i kanë nënshkruar marrëveshjet dhe kanë bërë pak për zbatimin e tyre.

Në raportin e “Freedom House” është përmendur, gjithashtu, reagimi i partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës ndaj “qasjes së ashpër të Kurtit në negociatat me Beogradin dhe mungesa e konsultimeve me komunitetin e serbëve të Kosovës”, çka, sipas raportit, “i ka komplikuar përpjekjet e qeverisë për t’u çliruar prej kësaj sfide afatgjatë”.

Në raportin për vitin 2023, “Freedom House” ka thënë se Ukraina ka shënuar përparimin më të madh në procesin e demokratizimit, ndërsa Serbia rënie më të madhe.

Prej 3.79 pikëve sa i ka pasur në vitin paraprak, Serbia tani është vlerësuar me 3.61 pikë. Rënia, siç është thënë, historike, u është atribuar përpjekjeve të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për ta konsoliduar pushtetin. “Të shtënat masive në maj patën nxitur protesta përgjatë

Dinari mbledh sërish javën tjetër në Bruksel kryenegociatorin e Kosovës dhe të Serbisë

PRISHTINË, 11 PRILL - I dërguari special i Bashkimit Evropian (BE) në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, pritet t'i thërrasë për takim në Bruksel kryenegociatorin Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç për t'i vazhduar diskutimet lidhur me çështjen e dinarit. Në një përgjigje për "reporteri.net", BE-ja ka konfirmuar se takimi do të jetë javën e ardhshme, por data nuk është përcaktuar ende.

BE-ja ka theksuar se në këtë takim do të diskutohet për një zgjidhje të përkohshme për çështjen e dinarit. "Ndërmjetësuesi i BE-së planifikon të thërrasë një takim tjetër javën e ardhshme në nivelin e kryenegociatorëve për të diskutuar një zgjidhje të përkohshme të çështjeve të shkaktuara nga rregullorja e fundit e Bankës Qendrore të Kosovës, me kusht që palët të jenë të gatshme të

angazhohen në bazë të ideve të paraqitura nga ndërmjetësuesi i BE-së", ka thënë një zëdhënës i BE-së. Më 4 prill ka qenë takimi i fundit në Bruksel për çështjen e dinarit, i cili ka përfunduar pa marrëveshje. Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, pas takimit të enjten e kaluar, ka thënë se Kosova është pajtuar me propozimin e emisarit të BE-së sa i përket çështjes së dinarit, por pala serbe ka kërkuar kohë shtesë.



Çitaku: Qeveria e Kosovës po i përçan shqiptarët në Maqedoninë e Veriut

PRISHTINË, 11 PRILL - Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka reaguar pas përplasjeve të fundit në mes të zyrtarëve të qeverisë dhe partisë së Ali Ahmetit në Maqedoninë e Veriut.

Çitaku e ka akuzuar qeverinë Kurti se është duke i përçarë shqiptarët në Maqedoninë e Veriut. Sipas saj, veprimet e zyrtarëve të pushtetit në Kosovë janë të turpshme dhe të rrezikshme. "Shqiptarët në Maqedoninë Veriore i kanë dalë hakut Kosovës. Na i kanë hapur dyert dhe zemrat në orët tona më të vështira. Pa kushte. Për më tepër djem e vajza erdhën dhe me vetmohim luftuan për lirinë tonë. Disa e dhanë edhe jetën. Dy dekada pas, shqiptarët në Maqedoninë Veriore janë faktorë me peshë. Janë më meritoret për mirëmbajtjen e kursit euroatlantik të vendit të tyre. E çka bënë kryeministri dhe



Qeveria e Kosovës sot? Ndërhynë brutalisht në zgjedhjet atje, duke

përçarë shqiptarët. Duke shpifur e manipuluar. Seç e ka një

mosdurim kryeministri Kurti për secilin lider politik të UÇK-së. E

turpshme. E mjerë. E rrezikshme", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Tahiri akuzon diplomacinë për dështim: Aleatët s'po e kërkojnë më nga Serbia njohjen e Kosovës

Prishtinë, 11 prill - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka komentuar kërkesën e ndërkombehtarëve ndaj Kosovës për themelimin

e Asociacion të Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka fajësuar kryeministrin Albin Kurti se pse më aleatët e Kosovës nuk janë duke kërkuar nga Serbia njohjen e

Kosovës. Tahiri ka shkruar në "Facebook" se kjo ka të bëjë me dështim të diplomacisë së Kosovës. "Pse bota po kërkon Asociacionin nga Kosova,

ndërsa nuk po kërkon njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia? Ky padyshim është dështim i Kurtit dhe diplomacisë sonë, mjerisht!", ka shkruar Tahiri.



verës, ndaj të cilave qeveria serbe është përgjigjur me zgjedhje të parakohshme të manipuluar në dhjetor. Për më shumë, udhëheqësia e Vuçiqit është përshkruar e atillë që e ka ruajtur pushtetin me procese të manipuluar zgjedhore, me dominim në media publike dhe private, përmes njollosjes së anëtarëve të opozitës dhe aktivistëve, si dhe frikësimit të udhëheqësive komunale.

Vendet e tjera të rajonit

"Freedom House" ka përmendur se më 2023 Maqedonia e Veriut është përballur me kthim të madh mbrapa në fushën e sundimit të

ligjit, pasi partitë kanë pasur mospajtime të theksuara për amendamentet kushtetuese, të cilat janë të domosdoshme për ta shmangur veton e Bullgarisë në rrugën e Shkupit drejt integriteteve evropiane.

Mali i Zi është thënë se ende po mbledh copëzat e veta pas krizës kushtetuese të vitit 2022 dhe se është përballur me qeverisje komunale jofunksionale dhe të korruptuara në mungesë të stabilitetit në nivel kombëtar.

Sa i përket Bosnjë-Hercegovinës, "Freedom House" ka vlerësuar se vlerësimi i shpifjes si vepër penale në Republikën Sërpska qysh prej korrikut të vitit të kaluar ka rritur presionin mbi gazetarët, në një

ambient që veçse ka qenë me trend të rënies sa i përket gjuhës së urrejtjes dhe sigurisë fizike.

Në përgjithësi, "Freedom House" ka thënë se prej 29 vendeve të analizuara prej Evropës Qendrore e deri tek Azia Qendrore, 10 kanë shënuar rënie, ndërsa vetëm pesë kanë shënuar përparim.

Organizata ndërkombehtarë e bën vlerësimin për nivelin e demokratizimit të vendeve të këtij rajoni prej vitit 1995 dhe e kategorizon secilin vend në bazë të llojit të regjimit.

Për të 20-tin vit me radhë, "Freedom House" ka regjistruar rënie të nivelit të demokratizimit në rajonin që vëzhgon.

Lufta e Rusisë në Ukrainë – e nisur

në shkurt të vitit 2022 – dhe pushtimi që ka kryer regjimi i Azerbajxhanit në rajonin e Nagorno-Karabakut, është thënë të kenë përshpejtuar një renditje të re gjeopolitike. "Fati i demokracisë evropiane tani varet kryesisht prej gatishmërisë së shteteve demokratike për të adoptuar një qasje më aktive ndaj sigurisë në rajon, sidomos duke e mbështetur Ukrainën", ka thënë Mike Smeltzer, bashkautor i raportit dhe hulumtues i lartë për Evropën dhe Euroazinë.

"Çdo dështim për t'i dalë zot demokracisë gjatë këtij momenti kritik do ta bëjë më të kushtueshëm kontrollimin e zgjerimit të regjimeve autoritare

në të ardhmen si në rajon ashtu edhe në botë. Shtetet e Bashkuara dhe Evropa duhet të veprojnë tani për ta garantuar humbjen e Moskës gjatë pushtimit të Ukrainës për t'i mbrojtur institucionet dhe normat demokratike", ka thënë ai.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre. /REL

Totaj viziton shoqatën "Vatra" në Nju-Jork

NJU-JORK, 11 PRILL - Në kuadër të vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka vizituar organizatën pan-shqiptare "Vatra" në Nju-Jork, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj shoqate Elmi Berisha. Ai e ka njoftuar kryetarin Totaj për aktivitetet

e shumta të kësaj organizate në shërbim të komunitetit shqiptar në Amerikë. Ndërsa kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka theksuar se anëtarë të shquar të "Vatra"-s kanë qenë personalitetet e njohura Fan S. Noli dhe Faik Konica, duke shtuar se ata kanë lënë gjurmë të

rëndësishme në historinë dhe kulturën shqiptare në ShBA. "Forcimi i lidhjeve dhe bashkëpunimi me organizatat shqiptare në diasporë është më se i domosdoshëm për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, në interes të kombit tonë", ka thënë Totaj.



Haxhi Shalës dhe Sabit Januzit u vazhdohet masa e paraburgimit



HAGË, 11 PRILL - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë është marrë vendim për vazhdimin e paraburgimit për Haxhi Shalën dhe Sabit Januzin.

Lajmi është bërë me dije gjatë konferencës javore të DhSK-së të enjten (11 prill 2024). "Paneli i Gjykatës Kushtetuese

përbëhet nga gjykatësit Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Romina Inkuti. Më 8 prill gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Sabit Januzit dhe Haxhi Shalës", ka thënë zëdhënësi i DhSK-së, Michael Doyle. Sipas tij, gjyqtari i procedurës paraprake, Nicolas

Guillou, ka konstatuar se për dy të akuzuarit ekziston rreziku i pengimit të procesit gjyqësor si dhe i arratisjes. "Ai konstatoi për të dy të akuzuarit se ekziston ende rreziku i arratisjes, pengimit të procesit gjyqësor si dhe rreziku i kryerjes së krimeve të tjera, veçanërisht duke pasur

parasysh se me ecurinë e procesit të nxjerrjes së materialeve, të akuzuarit kanë më shumë qasje në informacione të ndjeshme", ka thënë ai, raporton "Betimi për Drejtësi". Ndërsa në të njëjtën çështje gjyqësore është caktuar edhe paneli i Gjykatës Kushtetuese

lidhur me kërkesën e mbrojtjes së të akuzuarve për kundërshtimin e ndryshimeve në Rregulloren e Ndihmës Juridike nga Zyra Administrative. "Në çështjen gjyqësore Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala, kryetarja e Dhomave të Specializuara më 5 prill caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me kërkesën referuese të të akuzuarve me të cilën kundërshtojnë ndryshimet në Rregulloren e Ndihmës Juridike nga Zyra Administrative. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga gjykatësit Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Romina Inkuti. Më 8 prill gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Sabit Januzit dhe Haxhi Shalës", ka thënë Doyle.

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë çdo të enjte në orën 14:30 përmes platformës online "Zoom" mbajnë informim javor dhe ofrojnë informacione të përditësuara mbi zhvillimet e fundit lidhur me procedurat gjyqësore dhe veprimtaritë në këtë gjykatë.

Policia konfiskon tri vetura dhe gjobit shoferët

GJILAN, 11 PRILL - Policia e Kosovës në Gjiilan, në kuadër të një kontrolli rutinor, ka ndaluar tri vetura, shoferët e të cilave drejtonin mjetet e tyre edhe pse kishin ndalesë të drejtimit të mjetit si masë mbrojtëse dhe afat të skaduar të regjistrimit. Në njoftimin e policisë është thënë se ndaj tyre janë shqiptuar gjoja si dhe u janë vënë pikë negative. "Të njëjtëve sipas nenit 246 dhe 247

konform ligjit për rregullat në trafikun rrugor 08/L-186 i u është shqiptuar gjoja në vlerë prej 500 euro, pesë pikë negative dhe vazhdim i masën së përkohshme të ndalim vozitjes së mjeteve motorike në afat edhe për gjashtë muaj si dhe konfiskim i mjetit, respektivisht për dy kundërvajtje të mjetit të pa regjistruar nga 200 euro", ka njoftuar policia.



Bulliqi takohet me komandantin e ri të KFOR-it në Podujevë

PODUJEVË, 11 PRILL - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur në takim komandantin e ri të KFOR-it në Podujevë, Balint

Molnar dhe bashkëpunëtorët e tij. Bulliqi e ka uruar për detyrën e re komandantin e ri si dhe është shprehur i gatshëm për bashkëpunim të

ngushtë me KFOR-in në interes të ruajtjes dhe sigurisë publike. "Në këtë takim u diskutua për situatën e përgjithshme në komunën e

Podujevës si dhe për projektet që po zhvillohen gjatë kësaj kohe të cilat po e transformojnë qytetin", ka njoftuar komuna e Podujevës.



25 VJET NGA RËNIA HEROIKE E AGIM RAMADANIT, I NJOHUR SI KOMANDANT "KATANA"

Kosova përkujton Agim Ramadanin

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe të partive politike kanë përkujtuar të enjten ish-komandantin e UÇK-së, Agim Ramadanin, në 25-vjetorin e rënies heroike të tij në Koshare. Ata kanë vlerësuar se "Katana" është gërshetim i luftëtarit, piktorit dhe poetit që është shndërruar në hero. Po ashtu, ata kanë thënë se Agim Ramadani me luftën e tij për çlirimin e Kosovës ka nderuar të gjithë shqiptarët



kontributin e gjurmët e tij të pashlyeshme në rrugëtimin për liri e shtet-ndërtim. Lavdi e përjetshme, Heroit Agim Ramadani dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për liri!", ka shkruar Abdixhiku.

Agim Ramadani është përkujtuar edhe nga ish-komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se Agim Ramadani ka nderuar Dukagjinin, Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar. "Ndër protagonistët kryesorë të Betejës së Koshares gjithsesi është emri i një luftëtar të vërtetë e me virtyte të larta. Agim Ramadani, strategu që shkuli gurin e kufirit që ndante shqiptarët, emër ky që u bë tmerr për armikun. Shumë luftëtarë ranë në fushën e nderit nën emrin e brigadës që barti emrin e tij e shumë të tjerë i lanë gjymtyrët në kufirin shqiptaro-shqiptar. Agimi nga Zhegra e Gjilanit, e nderoi Dukagjinin, Kosovën e mbarë kombin shqiptar", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Po ashtu, Agim Ramadanin e kanë përkujtuar edhe ish-bashkëluftëtarët e tij në Koshare dhe bashkëshortja Shukrije Ramadani. Ajo në "Facebook" ka shkruar: "Ngrihu trimi im se bajlozi i zi ende sillet truallit tonë!". Agim Ramadani ka rënë më 11 prill të vitit 1999 në kufirin Kosovë-Shqipëri, konkretisht në betejën e Kosharës. Ai kishte ardhur nga mërgimi për t'i dalë zot atdheut të robëruar.

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 11 PRILL - Të enjten janë bërë 25 vjet nga rënja e ish-komandantit të UÇK-së, Agim Ramadani, i njohur si "Katana". Me këtë rast, ai është përkujtuar nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe nga liderët e partive politike.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Agim Ramadani u ka dhënë jetë ëndrrave dhe aspiratave të popullit të Kosovës për të qenë të lirë. "Agim Ramadani nuk ishte thjesht vetëm ushtarak, por një gërshetim i luftëtarit, poetit e piktorit, respektivisht një personalitet poliedrik i shndërruar në hero. Ai është njeriu i mërgatës, patrioti e guximtari që ëndrrën për lirinë e bëri realitet duke iu bashkuar UÇK-së dhe duke u përjetësuar në heroin emblematik të shembjes së kufirit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Ai dhe bashkëluftëtarët u dhanë jetë ëndrrave dhe aspiratave të popullit tonë për të qenë të lirë.

Heroizmi dhe trashëgimia e Agimit do të vazhdojnë t'i frymëzojnë brezat që do të vijnë. Qoftë i përjetshëm kujtimi për heroin Agim Ramadanin!", ka shkruar Osmani në "Facebook". Ndërsa kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka përkujtuar Agim Ramadanin me disa vargje të një poezie të tij. "A mjafton të presim vetëm, e të shikojmë duke larguar perden për të parë si na vjen liria? Agim Ramadani - komandant 'Katana', e dinte përgjigjen në këtë pyetje para se ta shkruante këtë poezi. Prandaj, radhitja në mesin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për t'u bërë pjesë e luftës për liri, ishte mënyra e tij për të thënë 'jo', nuk mjafton të shikojmë. Se liria nuk falet, por fitohet me gjak", ka shkruar i pari i PDK-së në "Facebook".

Po ashtu, Krasniqi ka thënë se Ramadani përmes luftës dhe vargjeve të tij jeton në zemrat e secilit shqiptar. "Lavdi heroit të Kosovës, i cili edhe sot në 25-vjetorin e rënies së tij heroike, përmes luftës dhe vargjeve të tij, jeton në zemrat e secilit shqiptar atdhedashës. Respekt, mirënjohje

dhe lavdi luftëtarëve dhe dëshmorëve të betejës së Koshares, të cilët, me brigadën e tyre të pagëzuar me emrin e Agimit, vazhduan luftën për çlirim deri në fund", ka shkruar Krasniqi.

Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka përkujtuar heroin Agim Ramadanin në 25-vjetorin e rënies. Ai ka thënë se në historinë tonë të lavdishme dhe të papërsëritshme, "janë disa ditë që aq sa na pikëllojnë, na bëjnë edhe më shumë krenarë". "Ditë të tilla janë këto të prillit, kur në majat e larta nën udhëheqjen e strategëve të luftës për liri, Agim Ramadani 'Katana' dhe Sali Çekaj, u thyje kufiri shqiptaro-shqiptar me Betejën e Koshares, atë më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në agimin e 11 prillit, në vend se t'i gëzoheshim rrugëtimit drejt çlirimit të Kosovës, lufta na e mori strategun më të mirë të kohës, luftëtarin e Heroin e Kosovës, Agim Ramadani, atje skaj bjeshkëve të ashpra ku edhe

pushon përjetësisht trupi i tij", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Më tutje, ai ka thënë se "kumti i trishtueshëm që në vijat e para të frontit në Koshare, ra Agim Ramadani, nuk i ligështoi shokët e luftës". "Ata tashmë kishin motivin për të vazhduar deri në çlirim. Kosova e pavarur, ishte ëndrra e të 114 dëshmorëve të Brigadës 138 të udhëhequr nga Agim Ramadani që tashmë po shkruanin me sakrificën e tyre një rrëfimë me të madhërishtë të luftës për liri e pavarësi. Sot, kujtojmë piktorin dhe shkrimtarin Agim Ramadani, që përmes vargjeve i dha jetë, luftës e lirisë. Në kohët më të vështira, kur lëshoj zë kushtrimi i atdheut, Agimi, si gjithmonë ishte në krye të detyrës, ndërsa vetë ai i paepur për liri e çlirim nuk ndihej i pëmbushur pa sakrificën më sublime edhe me vet jetën e tij. Në këtë përvjetor në nderojmë përjetësisht figurën shumëdimensionale, unike e të papërsëritshme të Agim Ramadanit; nderojmë dhe

Gjermania ia dhuron FSK-së automjetet ushtarake 'Rheinmetall'

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 PRILL - Në kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) "Adem Jashari" është mbajtur ceremonia e pranimit të donacionit në vlerë 2.7 milionë euro të automjeteve "Rheinmetall" nga Republika Federale e Gjermanisë për FSK-në.

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka deklaruar se vlera e këtij donacioni është 2.7 milionë euro. "Është kënaqësi dhe nder i veçantë që sot ta pranoj donacionin e radhës më vlerë 2.7 milionë euro. Rol të rëndësishëm ka partneri ynë,



andaj jemi shumë mirënjohës në vazhden e 3 milionë e 800 mijë euro. Falënderoj ambasadorin për kontributin

dhe sigurisht ky bashkëpunim do të vazhdojë tutje me qëllim për t'i kontribuar paqes dhe sigurisë në vend dhe rajon", ka thënë

Maqedonci.

Ndërsa ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka theksuar edhe një herë raportin mes dy shteteve Kosovë - Gjermani, duke theksuar bashkëpunimet milionëshe në fushën e sigurisë. "Mendoj se dua ta theksoj raportin e shkëlqyer mes Gjermanisë dhe Kosovës. Jam shumë i kënaqur të jem sot këtu gjatë donacioneve në vlerë milionëshe. E falënderoj ministrin Maqedonci për pjesëmarrjen në këtë ceremoni", ka thënë ambasadori Rohde. Rohde së bashku me ministrin Maqedonci kanë dorëzuar çelësat e pesë furgonëve ushtarakë. Që të dy bashkë kanë

parë nga brenda edhe një prej tyre.

Me këtë rast, ambasadori gjerman ka thënë se lidhja në mes të Gjermanisë dhe Kosovës është më afër një hap. "Sot lidhja në mes të Gjermanisë dhe Kosovës është më afër një hap. Kjo po bëhet përmes zyrtarëve tanë siç janë atashetë. Jam shumë i kënaqur të jem sot në këtë dhënie të donacionit të pesë kamionëve. E di që ky projekt ka filluar që nga viti 2022 me ministrin Mehaj dhe grupin përfaqësues. Kjo është një ndihmë për transport. Domethënë tashmë i kemi gjithsej 15 kamionë", ka thënë ambasadori Rohde.

Policia ukrainase diplomon në Kosovë për heqjen e minave

PRISHTINË, 11 PRILL - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka bërë me dije se grupi i parë i Policisë Kombëtare të Ukrainës dhe Shërbimeve Shtetërore të Emergjencave ka diplomuar në një iniciativë të përbashkët me komandën evropiane të ShBA-së dhe

FSK-së. Hovenieri ka treguar se ata kanë diplomuar për heqjen e minave. "Sot grupi i parë i Policisë Kombëtare të Ukrainës dhe Shërbimeve Shtetërore të Emergjencave u diplomua nga një iniciativë e përbashkët trajnimi e komandës evropiane të ShBA-së dhe Forcave të Sigurisë së

Kosovës për heqjen e sigurt të minave dhe mjeteve të municioneve të pashpërthyer. Krenar që e dëshmojmë këtë përpjekje për ta mbajtur popullin ukrainas të sigurt dhe për të qëndruar me partnerët tanë kosovarë në solidaritet me Ukrainën", ka shkruar Hovenieri në platformën "X".



Minatorët e "Trepçës" ndërpresin grevë

MITROVICË, 11 PRILL - Minatorët e "Trepçës" kanë arritur një marrëveshje me drejtorin e korporatës, Bashkim Kurti,

lidhur me pagat, pasi ata e kanë bojkotuar punën të enjten. Anëtarë i Kryesisë së Sindikatës së Minatorëve të "Trepçës",

Gani Osmani, ka deklaruar për "Klankosova.tv" se ata grevën e kanë ndërprerë pasi të gjithë minatorëve u ka dalë 40 për

qind e pagës së muajit mars. "Pjesa tjetër e 30-përqindëshit do të dalë brenda një jave", ka thënë Osmani.



Banka Botërore parasheh rritje ekonomike në Kosovë dhe në rajon

PRISHTINË, 11 PRILL - Banka Botërore ka parashikuar në një raport të enjten rritje ekonomike prej 3.2-përqindësh këtë vit dhe prej 3.5-përqindësh në vitin 2025 në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Rritja në vitin 2023 ra në 2.6 për qind nga 3.4 për qind sa ishte më 2022, kryesisht si pasojë e konsumit dhe tregtisë, duke pasqyruar ekonominë e dobët në Bashkim Evropian, i cili është partner i rëndësishëm i tregtisë për Ballkanin Perëndimor.

Në raportin e saj vjetor për Kosovën, Shqipërinë, Bonjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, Banka Botërore e ngriti parashikimin e rritjes për vitin 2024 për 0.2 për qind krahasuar me raportet paraprake, duke u bazuar në optimizmin se rajoni i ka tejkaluar krizat prej pandemisë së Covid-19. Por, ajo paralajmëroi për rreziqet e vazhdueshme të tregtisë dhe investimeve të dobëta me eurozonën, të cilat lidhen me dobësitë e vazhdueshme në rritjen globale, si dhe me mundësitë për rritjen e tensioneve gjeopolitike,

emigrimin, pasigurinë zgjedhore dhe inflacionin e vazhdueshëm.

Shkalla e inflacionit në rajon ra shumë, nga 14.3 për qind në janar 2023, në 5.1 për qind në dhjetor 2023.

Në Kosovë shkalla e inflacionit sillet në rreth 2 për qind, por çmimet e produkteve dhe shërbimeve kanë mbetur të larta prej se inflacioni ka arritur kulmin më 2022, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Atë vit Kosova e përfundoi me normë mesatare inflacioni rreth 12 për qind. Banka Botërore e paralajmëroi rajonin se i duhet patjetër t'i zbatojë një sërë reformash për ta ngushtuar hendekun mes zhvillimit në Bashkimin Evropian. Të gjitha gjashtë vendet e rajonit duan t'i bashkohen BE-së.

"Plani i ri i bllokut për rritje për Ballkanin Perëndimor paraqet një mundësi për ta stimuluar zhvillimin e ekonomik përmes reformave dhe investimeve, posaçërisht në ekonominë e gjelbër", ka thënë Xiaoqing Yu, drejtor i Bankës Botërore për



Ballkanin Perëndimor. Xiaoqing po i referohej planit prej 6 miliardë eurosh të BE-së për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Plani është paraqitur në nëntor të vitit 2023 dhe parasheh që dy miliardë euro të

jenë fonde të pakthyeshme, ndërsa katër miliardët të tjerë të jepen në formën e kredive të volitshme.

Nga secili vend është paraparë përgatitja e një agjende reformuese, të bazuar në

rekomandimet paraprake të trupave të BE-së, para vlerësimit dhe miratimit të saj nga Komisioni Evropian. Reformat në fushën e rendit dhe të sundimit të ligjit janë thelbësore për të përfutur mjete nga ky plan.

Inspektorati asgjëson 1 154 disqe për prerjen e hekurit dhe betonit



PRISHTINË, 11 PRILL - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht inspektorët e tregut, kanë realizuar inspektime në disa qytete të ndryshme në vendin tonë, gjatë të cilave të disa operatorë ekonomik kanë hasur në produktet "disqe për prerje të hekurit dhe betonit".

Produktet në fjalë, me afat të skaduar të përdorimit, ishin të brendeve të ndryshme, dimensioneve të ndryshme dhe me origjinë të vendeve të ndryshme.

Këto produkte paraqesin rrezik për përdorim nga konsumatorët dhe në të gjitha rastet operatorët ekonomikë kanë bërë shkatërrimin/asgjësimin e këtyre produkteve me afat të skaduar në prani të inspektorëve të tregut.

Me këtë rast, inspektorët e tregut kanë bërë largimin e këtyre produkteve nga tregu i brendshëm në sasi prej 1 154 copësh "disqe për prerje të hekurit dhe betonit", përkatësisht është bërë shkatërrimi/asgjësimi i tyre, prandaj në secilin rast janë marrë masa ndëshkuese në pajtim me legjislacionin në fuqi. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, mbetet e përkushtuar ta mbrojë shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve duke eliminuar nga tregu çfarëdo produkti që paraqet rrezik për përdorim, "prandaj ftojme të gjithë qytetarët, që nëse hasin në produkte të tilla në treg, t'i lajmërojnë inspektorët e tregut të cilët do të veprojnë konform legjislacionit përkatës në fuqi dhe kompetencave që ata kanë".

Murati njofton se ua ka bartur komunave 60 milionë euro të hyra vetjake

PRISHTINË, 11 PRILL - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se është bërë bartja e të hyrave vetjake të komunave në vlerë prej 60 milionë eurosh. Murati ka thënë se bartja në

këtë formë është bërë për të hyrat vetjake që kanë qenë të alokuara, kurse për pjesën e paalokuar, bartja sipas ministrit bëhet me vendime të kuvendeve komunale

përkatëse. "Në pajtim me nenin 9.6 të Ligjit të buxhetit, sot kam miratuar bartjen e të hyrave vetjake të komunave në vlerë prej 60 milionë eurove. Bartja në këtë formë bëhet për të hyrat

vetjake që kanë qenë të alokuara, kurse për pjesën e paalokuar bartja bëhet me vendime të kuvendeve komunale përkatëse", ka njoftuar Murati.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (17)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

-87-
Konfidenciale

E pabotueshme për shtetas të huaj

E botueshme për qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar
Zyra e Shërbimit të Fshehtë dhe Kërkimit
Raport 204-AR
20 gusht 1981

(U) Trazirat në Kosovë: ndikimi i tyre në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare

Përmbledhje

(U) Marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë janë përkeqësuar ndjeshëm që prej trazirave të fundit të shqiptarëve etnikë në krahinën e Kosovës. Zyrtarët jugosllavë kanë akuzuar Shqipërinë për nxitjen dhe organizimin e trazirave dhe për bashkëpunim me organizatat e emigrantëve anti-jugosllavë që kërkojnë shkatërrimin e shtetit jugosllav. Të tjerë, nga ana e saj, ka akuzuar jugosllavët, në veçanti serbët, për shfrytëzimin dhe persekutimin e pakicës shqiptare dhe për marrëveshje të fshehtë kundër Bashkimit Sovjetik.

(C) Aktualisht, ekziston një perspektivë e vogël për ndonjë përmirësim substancial në marrëdhëniet dypalëshe përsakohë mbetet në fuqi regjimi doktrinar dhe stalinist i Hoxhës. Edhe shfaqja e një udhëheqjeje më pragmatike në Tiranë nuk mund të ndryshojë marrëdhëniet, veçanërisht nëse kjo udhëheqje do të ndjehej e kërcënuar nga politikën jugosllave. Në këto rrethana, Tiranë mund të jetë mbase më e bindur ndaj propozimeve sovjetike sesa ka qenë nën regjimin e Hoxhës. Për jugosllavët, duken të pazgjidhshme problemet që lidhen me pakicën e tyre shqiptare të pabindur dhe me Shqipërinë armiqësore – së paku në aspektin afatshkurtër.

Reagimi fillestar jugosllav ndaj trazirave

(U) Trazirat në marsin dhe prillin e kaluar të zhvilluara nga shqiptarët etnikë në Kosovë (një krahinë autonome brenda Republikës së Serbisë që është më e madhja e gjashtë Republikave përbërëse të Jugosllavisë) përbënin krizën e parë të madhe për udhëheqjen e pas periudhës së Titos dhe kërcënimin më të rëndë për sigurinë e brendshme që prej

tronditjes nacionaliste kroate në vitin 1971. Sipas deklaratave zyrtare, trazirat – të cilat u organizuan nga studentët të Universitetit në Prishtinë, kryeqyteti i Kosovës, për të protestuar për kushtet e tyre ekonomike por që menjëherë morën nota politike dhe nacionaliste – lanë 9 persona të vdekur dhe më shumë se 250 të tjerë të plagosur. Këto statistika janë kundërshtuar nga regjimi shqiptar dhe organizata të ndryshme të emigrantëve anti-jugosllavë, të cilët akuzojnë se janë vrarë qindra njerëz pasi regjimi i ka shtypur brutalisht demonstratat.

(C) Trazirat e para më 11 mars përfshinin një numër të llogaritur prej 2000 studentësh të Universitetit, të cilët protestonin për kushtet e këqija të jetesës. Në demonstratën e 26 marsit në Prishtinë, parullat e studentëve shprehnin ankesat për shtypjen e shqiptarëve, kërkonin liri më të madhe të shtypit dhe liri të tjera, bënë thirrje për statusin e Republikës për Kosovën, dhe i thurin lavde Hoxhës dhe regjimit të Tiranës. Më 1 prill, rreth 10 mijë protestues të Prishtinës – përfshirë studentët, minatorë dhe punëtorë të tjerë – kërkonin lirimin e personave të arrestuar gjatë demonstratave të mëparshme. Demonstrata të ngjashme u zhvilluan edhe në disa qytete të tjera të Krahinës. Përleshjet midis autoriteteve lokale të sigurisë dhe demonstruesve i detyruan autoritetet jugosllave të dërgonin policinë speciale dhe forca ushtarake nga anë të tjera të vendit për të rivendosur rendin. Për një periudhë të caktuar, u vendosën rregulla të rrepta për kufizimin e udhëtimit brenda dhe jashtë krahinës, si dhe u ndaluan tubimet publike.

(U) Udhëheqësit jugosllavë u zunë në befasi nga dhuna dhe përmasat e trazirave. Kur u bë e qartë se ishin përfshirë segmente të mëdha të popullsisë shqiptare etnike (pothuajse 80% e banorëve të Kosovës që përbëjnë 1.7 milionë janë shqiptarë nga origjina) – jo vetëm studentët e pakënaqur të Universitetit, por edhe mësues, gazetarë, intelektualë të tjerë, punëtorë e madje dhe anëtarë partie në të gjithë Krahinën – zëdhënësi i regjimit akuzoi se “elementë të huaj armiqësorë” ishin prapa “aktiviteteve kundërrevolucionare”. Sipas jugosllavëve, këta elementë punonin me elementë emigrantë anti-jugosllavë (ustashë, kominformistë, zogistë dhe ballistë shqiptarë, grupe të ndryshme Marksiste-Leniniste të mbështetur nga Tiranë dhe “punëtorë sezonalë” shqiptarë në Evropën Perëndimore), të cilët kërkonin të destabilizonin Jugosllavinë. Kishte gjithashtu insinuat se një rol në organizimin

e këtyre trazirave kishin edhe “forcat e këqija”, “shërbimet e inteligjencës” dhe “qendrat e spiunazhit”.

(C) Disa jugosllavë në fshehtësi kishin frikën e një “komploti” që përfshinte sovjetikët, bullgarët dhe shqiptarët. Armiqësia e Tiranës ndaj Moskës dhe Sofies në përgjithësi kishte rënë me argumentin se ishte arritur njëfarë “mirëkuptimi” për të çuar përpara objektivat e përbashkëta të tre regjimeve – shkatërrimin e Federatës jugosllave, ku Shqipëria do të aneksonte zonat e banuara nga shqiptarët dhe Bullgaria do të aneksonte Maqedoninë (zonat e banuara nga shqiptarë në Maqedoni dhe Mal të Zi afër me kufirin me Shqipërinë).

(C) Sulmet jugosllave ndaj kominformistëve dhe pretendimet për bashkëpunim me sovjetikët provokuan një përgjigje të fortë të dhënë nga gazeta “Pravda” e Moskës nga mesi i prillit. Megjithatë ajo u hodh menjëherë poshtë nga jugosllavët, shumë shpejt u qetësuan polemikat midis medias sovjetike dhe asaj jugosllave mbi Kosovën. Asnjëra palë, mesa duket, nuk dëshironte që të ndërlikonte më tej marrëdhëniet e tyre duke shtuar Kosovën në listën e çështjeve të diskutueshme të pazgjidhura, të tilla si Afganistani, Kamboxhian dhe lëvizjen ndërkombëtare komuniste. Gjithsesi, shumë jugosllavë mbeten të bindur mbi rolin sovjetik në këto trazira, megjithatë nuk janë në gjendje që të ofrojnë prova.

Tiranë e akuzuar

(U) Megjithatë disa zyrtarë jugosllavë aludonin se Tiranë kishte gisht në trazirat e Kosovës, veçanërisht kur komentonin manifestimet e “nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, Tiranë nuk u akuzua për përgjegjësi të drejtpërdrejtë për disa javë. Më pas, më 7 prill, një kryeartikull në të përditshmen shqiptare “Zëri i

Popullit”, dënonte “brutalitetin” jugosllav në shtypjen e trazirave dhe mbështeste kërkesat që Kosovës t’i jepet statusi i Republikës.

(U) Regjimi jugosllav u përgjigj me një fushatë masive propagande, e cila e akuzonte Shqipërinë:

- se kishte nxitur dhe organizuar “aktivitetet nacionaliste, irredentiste dhe kundërrevolucionare në Kosovë”;
- se ka pasur “pretendime të hapura territoriale” kundër Jugosllavisë dhe ka kërkuar që t’ia aneksonte Kosovën dhe zona të tjera “Shqipërisë së Madhe”;
- se ka përdorur diplomatët e saj dhe agjencitë e inteligjencës në Jugosllavi dhe në vendet e treta për të kontaktuar dhe rekrutuar elementët anti-jugosllavë;
- për dhunë flagrante dhe abuzim të bashkëpunimit jugosllavo-shqiptar dhe marrëveshjeve të shkëmbimit për të përhapur “parimet staliniste” të Partisë shqiptare dhe për të glorifikuar udhëheqësin e Partisë Hoxha, ndërkohë që dënonte udhëheqësit e Jugosllavisë, si dhe politikën e saj të brendshme dhe të jashtme; dhe
- për ndërhyrje të vazhdueshme në punët e brendshme të Jugosllavisë.

(C) Fushatat intensive që zgjasnin prej muajsh të tërë përfshinin sulmet publike ndaj Shqipërisë nga udhëheqësit kryesorë politikë të Jugosllavisë. Sidoqoftë, me gjithë sharjet dhe akuzat e shumta, nuk u paraqit asnjë provë e rëndë mbi përfshirjen e drejtpërdrejtë të Tiranës në këto trazira (udhëheqësit jugosllavë mbase nuk do t’i zbulonin prova të tilla edhe nëse ato ekzistonin pasi nëse do e bënin një gjë të tillë, atëherë praktikisht do të detyronin Beogradin që të shkëpuste marrëdhëniet me Tiranën. Këta udhëheqës mund ta kenë parë si më të përshtatshme që të përdornin Shqipërinë më të vogël, më të dobët – më tepër sesa BRSS – si kokë turku për të shmangur

vëmendjen nga dështimet e tyre politike në Kosovë dhe më gjerë).

(U) Disa zyrtarë jugosllavë treguan skepticizëm në lidhje me shtrirjen e përfshirjes së huaj në Kosovë duke argumentuar në të vërtetë se theksimi i tepërt i “elementëve të huaj armiqësorë”, mund të ishte jo produktiv. Ata thanë se udhëheqja duhej të ishte e hapur në vlerësimet e saj ndaj “shkaqeve dhe pasojave të ngjarjeve në Kosovë”. Sipas analizës së tyre, duket se Tiranë nuk kishte ndonjë arsye për të nxitur paqëndrueshmëri në Jugosllavi; Është qartazi në interesin e vetë Shqipërisë që të ketë një Jugosllavi të fortë dhe të bashkuar për t’i rezistuar çdo kërcënim sovjetik kundër vendeve të Ballkanit, veçanërisht Shqipërisë.

Politika të reja ndaj Shqipërisë
(U) Ndërkohë që rritje preokupimi i tyre për Kosovën, udhëheqësit jugosllavë pohuan se autoritetet federale dhe serbe në të ardhmen do të ushtronin mbikëqyrje dhe kontroll më të ngushtë mbi marrëdhëniet me Shqipërinë. Marrëdhëniet ishin kanalizuar kryesisht përmes zyrtarëve të Kosovës (d.m.th. shqiptarëve etnikë) – meqenëse Tiranë kishte këmbëngulur dhe Jugosllavia kishte rënë dakord. Vetëm tregtia ishte zhvilluar në nivel federativ; Tiranë kishte kufizuar praktikisht të gjitha shkëmbimet kulturore, arsimore, turistike dhe sportive me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Liria e veprimt e Tiranës kishte qenë në përputhje me politikën jugosllave se shqiptarët në Jugosllavi dhe, mbi të gjitha, në Kosovë, duhej të vepronin si “urë” në promovimin e marrëdhënieve dypalëshe.

(C) Dështimi i dukshëm i kësaj politike i kishte detyruar zyrtarët jugosllavë të vepronin për të kundërshtuar influencën shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni ku nacionalizmi shqiptar kohët e fundit ishte bërë më i theksuar. Marrëveshje dhe



shkëmbime të ndryshme ishin anuluar ose pezulluar; Për shembull, më 23 korrik, autoritetet arsimore “rekomandonin” që të pezulloheshin të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit midis Universitetit të Tiranës dhe universiteteve jugosllave (në Prishtinë, Shkup dhe Titograd). Më pas, jugosllavët akuzuan profesorët nga Shqipëria, të cilët jepnin mësim në Universitetin e Prishtinës, se kishin përhapur nacionalizmin shqiptar dhe hidhnin akuza se shumë tekste shkollorë në gjuhën shqipe të importuara për përdorim në institucionet arsimore jugosllave ishin thjesht fletushka propagandistike.

(U) Zyrtarët jugosllavë planifikojnë gjithashtu që të përdorin radio transmetuesin e Prishtinës në mënyrë më efektive për transmetim në të ardhmen në Shqipëri. Megjithëse media jugosllave kishte injoruar me të madhe sulmet e kaluara ideologjike të Tiranës ndaj Jugosllavisë – me shpresën që do të shmangte polemikat dhe kështu do të përmirësonte marrëdhëniet dypalëshe – kjo politikë duhet ndryshuar. Do të bëhen përpjekje për t'i vënë në dukje shqiptarëve si në Jugosllavi dhe Shqipëri karakteristikat më të këqija të regjimit të Hoxhës.

Përgjigja e Tiranës ndaj Kosovës (C) Megjithëse protestat e para në Prishtinë u zhvilluan më 11 mars, duket se media shqiptare fillimisht e ka injoruar këtë nxjete në Kosovë. Udhëheqësit shqiptarë mund të kenë pasur dëshirë të qëndrojnë në heshtje pjesërisht në interes të marrëdhënieve të mira me Beogradin, ose, ndoshta, për faktin se nuk ishin vendosur ende se si të reagonin sa më mirë ndaj situatës. Edhe pas demonstratave të dhunshme dhe të përhapura më 1 dhe 2 prill, nuk pati ndonjë reagim të menjëhershëm nga Tiranë: më 2 dhe 3 prill, media shqiptare kishte vetëm përshkrime të shkurtër të drejtpërdrejta të incidenteve, duke përdorur materiale nga burimet e agjencive jugosllave të lajmeve.

(U) Ky qëndrim i matur mori fund me një artikull të gjatë dhe të ashpër në gazetën “Zëri i Popullit” të datës 7 prill. Artikulli akuzonte se varfëria dhe diskriminimi kundër popullsisë shqiptare në Kosovë ishin përgjegjëse për trazirat. Gjithashtu, artikulli akuzonte jugosllavët dhe, mbi të gjitha, serbët se kishin shfrytëzuar burimet minerale të Kosovës në dobi të tyre; dhe miratonte pa ekuivoke kërkesën e protestuesve që Kosova të bëhej Republikë.

(U) Në maj, një tjetër artikull i “Zërit të Popullit” trajtonte padrejtësitë që shqiptarët kishin vuajtur qëllimisht që para periudhës së Luftës së Parë Botërore në duart e serbëve dhe (me formimin e Jugosllavisë në vitin 1918) jugosllavëve. Artikulli akuzonte komunistët jugosllavë për poshtërsi që nuk kishin lejuar regjimin e Hoxhës që të mbante Kosovën dhe zona të tjera të banuara nga shqiptarët në Jugosllavi që i ishin dhënë

Shqipërisë (atëherë, nën sundimin e Italisë) gjatë Luftës së Dytë Botërore – pasi shqiptarët kishin qenë aleatë të Jugosllavisë në “Luftën Nacionalçlirimtare”. Artikulli i referohej një takimi të vitit 1946 midis Hoxhës dhe Titos, ku citohej se ky i fundit kishte pranuar se këto zona me të drejtë duhej t'i përkisnin Shqipërisë “... por jo tani sepse reaksionarët e Serbisë së Madhe nuk do të pranonin diçka të tillë”. Politikën e Titos pas luftës ndaj Shqipërisë janë përshkruar si “të egra dhe asgjësuese”.

(U) Megjithëse Tirana zor se mund të krahasohej me volumin e fushatës së Jugosllavisë, sulmet e saj ishin po aq të dëmshme sa edhe sajësat e zëdhënësve të Beogradit. Praktikiqisht, Tirana censuroi çdo aspekt të politikave të jashtme dhe të brendshme të Jugosllavisë, të kaluara dhe aktuale – duke përfshirë vetë-menaxhimin, mos-angazhimin, emigracionin e “punëtorëve sezonalë” jugosllavë, turizmin, aksesin e sovjetikëve dhe amerikanëve në portet jugosllave, borxhet dhe kreditë e huaja. Në të njëjtën kohë, Tirana mohoi me këmbëngulje çdo ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë, çdo qëllim për të shkatërruar Jugosllavinë apo çdo dëshirë për territore jugosllave, por këmbënguli se do të mbronte të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, “veçanërisht kur këto të drejta mbyten me gjak, siç ndodhi kohët e fundit në të gjithë Kosovën”.

(U) Tirana akuzoi jugosllavët, veçanërisht serbët se i kanë trajtuar shqiptarët në Jugosllavi qëllimisht “si qytetarë të dorës së dytë” dhe kanë ushtruar “gjenocid”. Thuhej se synohej një komplot “sovjeto-serb” kundër shqiptarëve në Jugosllavi dhe vetë Shqipërinë, i cili synonte gjithashtu të fitonte dominimin serb në të gjithë Federatën Jugosllave. Sipas Tiranës, për arsye historike, fetare dhe politike, serbët ishin aleatët natyrorë të sovjetikëve; të dyja palët ishin bërë “armiq të betuar” të Shqipërisë. Qëllimi përfundimtar i këtij komploti ishte që të lejoheshin sovjetikët të çonin përpara “depërtimin e tyre strategjik, hegjemonist dhe ekspansionist” ndaj Jugosllavisë dhe Ballkanit. Kosova ishte objektivi aktual i këtij “komploti sovjeto-serb” me Bosnjën, Slloveninë dhe më pas Kroacinë (Tirana i karakterizonte Slloveninë dhe Kroacinë si “pro-perëndimore dhe pro-amerikane”) dhe si vende që kërkonin pavarësinë politike nga “hegjemonizmi” serb.

(U) Mediet shqiptare kritikuan fillimisht sllovenët dhe kroatët për “hegjemonizëm” dhe i etiketuan zyrtarët shqiptarë etnikë në Kosovë si “renegatë” dhe “tradhtarë”. Megjithatë, më vonë mesa duket, media kërkoi të shfrytëzonte mosmarrëveshjet e fshehura nacionaliste, veçanërisht midis serbëve dhe kroatëve. Media i paralajmëroi sllovenët dhe kroatët që të mos mashtrroheshin nga akuzat serbe dhe sovjetike se Shqipëria – në mbrojtje të të



drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi – kishte ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe kishte kërcënuar pavarësinë dhe integritetin territorial të Jugosllavisë. Tirana e përshkroi veten si “bastion i pathyeshëm” kundër “imperializmit dhe revizionizmit sovjetik” dhe vlerësoi pakicën shqiptare në Jugosllavi si një faktor i rëndësishëm për stabilitetin e Federatës, si dhe si “pengesë e fuqishme kundër sulmeve sovjetiko-bullgare” që kërcënonin popujt e Jugosllavisë, Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

(U) Hoxha dënon politikën Jugosllave për Kosovën Propagandistët shqiptarë përdorën komentet e Hoxhës për Kosovën për të nënvizuar rëndësinë e fushatës së tyre kundër Jugosllavisë. Në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë të datës 15-16 qershor, Hoxha foli për “sulmet e egra dhe shpifëse” të udhëheqjes jugosllave kundër Shqipërisë, ndërsa udhëheqja shqiptare i ishte përmbajtur “pozitës së moderuar, parimore dhe të ftohtë” ndaj Kosovës. Komiteti Qendror miratoi “me unanimitet” këtë qëndrim. U publikuan shkrimet e vitit 1966 të Hoxhës në lidhje me Kosovën për të mbështetur akuzat e mizorive jugosllave kundër shqiptarëve. Më pas, ai kishte dënuar Titon si “renegat” dhe “revizionist” dhe akuzoi udhëheqësit jugosllavë për “gjenocid” në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Ai tha se shqiptarët në këto zona ishin nën “pushtetin e terrorit... që në ditët e para tëçlirimit. Ky terror vazhdon duke rritur gjithnjë e më shumë barbarizmin ende sot”. Hoxha gjithashtu pohoi të drejtën e regjimit të tij për të mbrojtur “interesat jetësore” të shqiptarëve në Jugosllavi.

Protesta kundër prishjes së marrëdhënieve

(U) Me intensifikimin e polemikave, marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë u përkeqësuan deri në pikën e tyre më të ulët prej vitesh, duke përmbysur kështu tendencën e ngrohtë që kishte qenë e dukshme që prej prishjes shqiptaro-kineze në vitin 1978. Vendimi jugosllav për të prishur marrëdhëniet dukej i pashmangshëm në fund të majit, pas hedhjes së bombës në ambasadën jugosllave në Tiranë,

protestave zyrtare jugosllave dhe kundërshtimit të tyre nga Tirana, dhe akuzave shqiptare se jugosllavët kishin realizuar hedhjen e bombës për “provokim”. Në një pikë të caktuar, shqiptarët në të vërtetë i nxitën jugosllavët të prishin marrëdhëniet.

(C) Gjatë gjithë shkëmbimeve të hidhura, disa zyrtarë në Beograd (dhe padyshim në Tiranë) kërkuan haptazi të shmangin prishjen e marrëdhënieve. Këta zyrtarë, natyrisht e ndjenin që prishja e marrëdhënieve nuk ishte në interesin e jugosllavëve dhe se Moskë do të ishte përfituesi kryesor. Më 9 qershor, zëvendës/sekretari i jashtëm jugosllav, Peshiq, deklaroi se Jugosllavia dëshironte marrëdhënie të mira me Shqipërinë, por vetëm mbi bazën e respektit të rreptë për parimet e “pavarësisë, barazisë, sovranitetit, integritetit territorial, mos-ndërhyrjes në punët e brendshme dhe reciprocitetit” (shqiptarët përdorën gjuhë të tillë të ngjashme kur diskutonin marrëdhëniet dypalëshe). Peshiq deklaroi se marrëdhëniet e mira ishin në interesin afatgjatë të të dy vendeve dhe në interes të paqes dhe sigurisë në Ballkan.

(U) Në diskutimet për Kosovën dhe rolin e pretenduar shqiptar atje, zyrtarë të ndryshëm jugosllavë paralajmëruan Tiranën me ton plot nënkuptim që të shqyrtonte se çfarë efekti do të kishin veprimet e saj – qoftë të miratuara nga ajo vetë apo në marrëveshje të fshehtë me të tjerë – në nxjeten e interesave të “gjithë atyre që janë armiq me Jugosllavinë dhe vetë Shqipërinë”. Mbështetja e Tiranës për “elementët nacionalistë dhe irredentistë” në Jugosllavi dhe “sulmet e saj ndaj integritetit territorial të Jugosllavisë” thuhej se kërcënonin vetë pavarësinë e Shqipërisë: “nacionalizmi i Shqipërisë së Madhe” do të nxiste nacionalizma të tjera në Ballkan (duke përfshirë nacionalizmin grek, bullgar dhe serb) dhe do të shfrytëzohej nga ata që dëshironin ta kthenin këtë zonë në “fuqi baruti”.

(U) Shqipëria insistoi të shprehej se dëshironte “marrëdhënie të sinqerta dhe normale tregtare”. Ajo vlerësoi shkëmbimet tregtare dhe kulturore si shkëmbime në interes

të të dy vendeve. Megjithatë, ajo përbuzi pretendimet jugosllave mbi “bujarinë, tolerancën dhe durimin... gjatë 32 viteve të fundit” dhe hodhi poshtë pretendimet jugosllave se Shqipëria kërkonte trajtim të privilegjuar në marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë. Gjithashtu, Shqipëria e akuzoi Beogradin se kishte caktuar çmime të tepruara për mallrat jugosllave ndërkohë që kishte vënë çmime të ulëta për mallrat shqiptare, duke vendosur kështu “pengesa serioze” në rrugën e tregtisë dhe duke shkelur disa nga marrëveshjet ekonomike që prej trazirave të Kosovës.

Faktori sovjetik në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare

(C) Si udhëheqësit jugosllavë dhe ato shqiptarë janë shqetësuar një një kohë të gjatë për kërcënimin sovjetik ndaj regjimeve të tyre dhe mundësinë që BRSS mund të ishte në gjendje të përdorte territorin e palës tjetër si bazë për subversion. Ndërkohë që po afrohej epoka post-Tito, veçanërisht kur Tito u shtrua në spital, thuhet se shqiptarët ishin të shqetësuar se pasardhësit e Titos nuk do të ishin në gjendje t'i rezistonin presioneve sovjetike për të fituar pozitë të favorizuar në Jugosllavi. Jugosllavët - të shqetësuar për pasiguritë e vazhdimësisë pas Hoxhës - u përpoqën të përmirësonin marrëdhëniet me Shqipërinë me qëllim që të kishin një kuptim më të mirë të zhvillimeve aty dhe të kundërshtonin përpjekjet e Moskës për të rritur influencën politike, ekonomike dhe ushtarake në mesin e zyrtarëve shqiptarë.

(C) Në bisedat private dhe deklaratat publike, zyrtarët jugosllavë dhe shqiptarë kanë treguar se janë të ndërgjegjshëm që çdo përkeqësim serioz në marrëdhëniet e tyre mund të kishte efekt negativ në stabilitetin e brendshëm të të dy vendeve, dhe në sigurinë e Ballkanit në përgjithësi. Me gjithë mosmarrëveshjet e hidhura për Kosovën, Shqipëria kishte përsëritur kohët e fundit zotimin e saj të mëparshëm për të luftuar “sup më sup” me jugosllavët nëse këta të fundit do të goditeshin nga BRSS.

(C/NF) Sidoqoftë, megjithëse nuk ka shenja se Hoxha ka ndryshuar armiqësinë e tij të

papajtueshme me "revizionistët" sovjetikë, disa jugosllavë dyshojnë se duhet të ketë marrëveshje të fshehtë midis Moskës dhe Tiranës kundër Beogradit. Ata besojnë se elementët pro-sovjetikë në Tiranë janë thjesht duke pritur vdekjen e Hoxhës për të lidhur Shqipërinë në aleancë me BRSS. Ata që janë dyshues për një aleancë të tillë, kanë frikë se një nga hapat e para do të përfshijë shfrytëzimin e armiqësive mbi kombësinë në Jugosllavi. Sipas burimeve greke, kryeministri Gjuranoviq i ka thënë zyrtarëve grekë gjatë vizitës së tij në Athinë më 17-19 korrik se hetimet intensive të bëra mbi trazirat në Kosovë nuk zbuluan asnjë përzjerje të Shqipërisë në këto trazira, por zbuluan se sovjetikët kishin gisht në to. Zyrtarë të tjerë të njohur jugosllavë kanë pranuar në fshehtësi shqetësimin se shërbimet e inteligjencës sovjetike dhe bullgare po shfrytëzojnë çështjen e kombësisë në Jugosllavi dhe mund të kenë krijuar tashmë kontakte indirekte me shërbimin inteligjent shqiptar përmes organizatave të emigrantëve shqiptarë anti-jugosllavë. Një gazetë jugosllave - ndërkohë që diskutonte përfshirjen e supozuar të Tiranës në planifikimin dhe organizimin e trazirave në Kosovë - pretendoi ekzistencën e një "programi" për vendet socialiste të udhëhequra nga Shqipëria, për të "çliruar" Jugosllavinë.

(U) Për më tepër, një koment i medias sovjetike i datës 10 qershor, ku vlerësohej roli historik i Lidhjes së Prizrenit Shqiptar në bashkimin e popullit shqiptar "kundër pushtuesve të huaj", duhet të ketë ngritur dyshime tek jugosllavët mbi përpjekjet më të fundit të sovjetikëve për t'i ardhur rrotull Shqipërisë. Artikulli, i cili përkujtoi 103-vjetorin e krijimit të Lidhjes, duket se hodhi poshtë akuzat shqiptare se sovjetikët kanë qëndruar në krah të serbëve (dhe jugosllavëve) kundër shqiptarëve.

(C) Interesat jugosllave në Shqipëri Pozita gjeografike e Shqipërisë e bën atë që të jetë një vend i rëndësishëm nga ana strategjike për sigurinë e Jugosllavisë. Si rezultat, udhëheqësit jugosllavë kanë kërkuar që në mënyra të ndryshme të dominojnë në Shqipëri (si në periudhën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore) ose në të kundërt të zbusin mosbesimin dhe armiqësinë tradicionale shqiptare - pa shumë sukses. Megjithatë, më shpesh udhëheqësve të Beogradit u është dashur të përballen me një situatë në të cilën Shqipëria - që prej pavarësisë së saj në vitin 1912 - është dominuar nga fuqi kundërshtarë (Austro-Hungaria, Italia, BRSS dhe Kina).

Ngritja e regjimeve komuniste në Jugosllavi dhe Shqipëri pas luftës nuk ndikoi shumë për të qetësuar armiqësitë e gjata. Disa komunistë udhëheqës jugosllavë e trajtonin nganjëherë regjimin në Tiranë sikur kishin të bënin praktikisht me një shtet vasal, duke i trajtuar shqiptarët në Tiranë dhe Jugosllavi me një përbuzje që zor se mund të



fsihihej. Çdo shpresë që Tito mund të ketë pasur për ta përfshirë Shqipërinë si Republikë të shtatë në Federatën Jugosllave mori fund kur Hoxha u rreshtua në krah të Stalinit në vitin 1948. Hoxha më pas eliminoi nga udhëheqja rivalët e tij pro-jugosllavë dhe nxiti irredentizmin kundër Jugosllavisë. Gjatë viteve, veçanërisht që prej prishjes shqiptaro-kineze, e cila e la Tiranën "pa protektor", dhe bamirës ekonomik, disa zyrtarë jugosllavë tentuan t'i etiketojnë sulmet politike dhe ideologjike të Shqipërisë ndaj "revizionizmit" jugosllav si sulme me pasoja të vogla. Ato e ndjenë se ishte shumë e rëndësishme që të zbuteshin dallimet dhe të kërkoheshin mënyra, sado modeste, për të rritur kontaktet me zyrtarët shqiptarë dhe në këtë mënyrë për të shtuar perspektivat për influencë të Jugosllavisë në Shqipëri pas epokës së Hoxhës (shumica e udhëheqësve jugosllavë janë pajtuar me armiqësinë e paepur të Hoxhës dhe me përmirësimin e vogël substancial në marrëdhëniet dypalëshe gjatë jetës së tij).

Perceptimet e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë Mosbesimi i Shqipërisë ndaj Jugosllavisë është rrënjësor në shekuj në antagonizmat dhe rivalitetet shqiptaro-serbe. Për Hoxhën dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë, regjimi komunist i Jugosllavisë nuk është fqinj më i mirë sesa paraardhësit e tij "monarkistë" apo "fashistë". Frika e ambicieve jugosllave ishte një faktor i rëndësishëm në vendimin e Hoxhës për të lidhur regjimin e tij me Stalinin; gjithashtu, kjo luajti një rol të veçantë në prishjen e Hoxhës me sovjetikët, pasi ai kishte frikë se rivendosja e marrëdhënieve miqësore Tito-Hrushov do ta mundësonte Jugosllavinë që të rifitonte influencën e saj në Shqipëri. Përfundimisht, përmirësimi gjithnjë në rritje i marrëdhënieve jugosllavo-kineze në mesin e viteve 1970, mishëruar nga vizita fitimtare e Titos në Kinë në vitin 1977 dhe vizita e Hua Guo-Feng në Jugosllavi në vitin 1978, kontribuoi në ftohjen midis Pekinit dhe Tiranës.

Hoxha, 72 vjeç, ka udhëhequr Partinë Komuniste Shqiptare që në vitin 1943. Ai nuk i ka falur

asnjëherë komunistët jugosllavë që i ripërfshinë zonat - Kosovën dhe kufijtë perëndimorë të Maqedonisë - të cilat Shqipëria i aneksoi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Duke pasur parasysh këtë përvojë, si dhe qëndrimet izolacioniste dhe ksenofobike të regjimit të Hoxhës, nuk të çudit aspak dyshimi i tij obsesiv për Jugosllavinë.

Fushata politike dhe ideologjike e Shqipërisë kundër Jugosllavisë gjatë tre dekadave të fundit dhe kërkimi nga ana e saj për aleatë kundër Jugosllavisë janë krijuar për të penguar "hegemonizmin jugosllav" dhe për të përfshirë përfundimisht pakicat shqiptare të Jugosllavisë në "Shqipërinë e Madhe". Megjithëse Tirana proteston publikisht se nuk ka plane territoriale ndaj Jugosllavisë, ajo ka shpallur gjithashtu se "... kombi shqiptar është një, pavarësisht se një pjesë e tij jeton në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe pjesa tjetër në tre pjesët e Jugosllavisë Federale". Megjithëse arsyet e vendimit shqiptar për të përmirësuar marrëdhëniet me Beogradin në fund të viteve 1970 nuk dihen, Hoxha mund ta ketë ndërjerë se - pas prishjes me Kinën - ishte e nevojshme që të vendoseshin lidhje tregtare/ekonomike për të përballuar vështirësitë ekonomike të Shqipërisë, të cilat përfshinin standardin më të ulët të jetesës në Evropë. Jugosllavia ishte e përshtatshme dhe e gatshme - për arsye taktike dhe strategjike. Për më tepër, vendimi i Titos për të përmirësuar fatin e popullsisë shqiptare në Kosovë, pjesërisht në dëm të serbëve dhe malazezëve atje, mund të ketë qenë faktor në arsyetimin e Hoxhës - veçanërisht nëse ai shihte mundësi unike për të çuar përpara qëllimet e tij politike dhe ideologjike në Kosovë.

Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare "përmirësohen" (U) Me këmbënguljen e Tiranës, marrëdhëniet me Jugosllavinë gjatë viteve të fundit janë zhvilluar më shumë në nivel shtetëror/qeveritar sesa politik. Janë parashikuar disa ndërmarrje të përbashkëta në sektorin ekonomik: Projekte të lidhjes hekurudhore, rrjetit të energjisë elektrike, teknologjisë së energjisë hidraulike dhe rritjes së shërbimit ajror. Shembulli më i dukshëm i

përmirësimit të marrëdhënieve dypalëshe ndodhi në korrik 1980: Ministri i Tregtisë së Jashtme të Shqipërisë bëri një vizitë zyrtare në Jugosllavi, duke përfshirë Maqedoninë dhe Kosovën. Kjo ishte vizita e parë ministrore shqiptare në Jugosllavi, që përpara prishjes Tito-Stalin. Që nga koha e vizitës, Jugosllavia është bërë partneri drejtues tregtar i Shqipërisë.

(U) Gjatë kësaj periudhe, menjëherë pas Titos (Tito vdiq në maj 1980), Shqipëria u bë më e kujdesshme në komentet e saj për statusin e Kosovës. Për shembull, nuk u tha asgjë për gjyqet e qershorit 1980 të "irredentistëve shqiptarë" të akuzuar për subversion. Kjo heshtje ishte në kundërshtim me kritikën e mëparshme të Shqipërisë për gjyqet të tilla nacionaliste dhe kohët e fundit, me denoncimin e menjëhershëm nga ana e Tiranës të gjyqeve të pesë shqiptarëve etnikë në Maqedoni këtë maj. Tirana i kishte etiketuar këto gjyqe - të cilat rezultuan në dënime të ashpra me burgim për akuzat e formimit të një organizate ilegale që synonte bashkimin e shqiptarëve në Jugosllavi me ato në "Shqipërinë e Madhe" - si një farsë, ku autoritetet jugosllavo-maqedonase përdornin metoda si ato të "fashistëve bullgarë" në Luftën e Dytë Botërore.

(C) Ndërkohë shkëmbimet arsimore/kulturore dhe tregtare arritën nivele të paprecedentë. Tirana bëri të qartë se përpjekjet e saj do të ishin kryesisht ideologjike dhe nacionaliste në fokus - të drejtuara nga shqiptarët në Jugosllavi. Efekti i kësaj propagande për popullsinë shqiptare të pabindur në Kosovë nuk mund të përcaktohet, por vetë përpjekja është planifikuar dhe organizuar me kujdes. Regjimi i Hoxhës e dinte se përpjekja e tij do të kishte një përgjigje të gjerë dhe dashamirëse:

- Kosova kishte qenë burim tradicional i pakënaqësisë politike dhe ekonomike që në fund të Luftës së Dytë Botërore, ku popullsia shqiptare nuk e dëshironte influencën serbe aty; - Kosova është gjithashtu zona më e prapambetur dhe e ulët ekonomikisht e Jugosllavisë me gjithë sakrificat e konsiderueshme të republikave dhe kombësive të

tjera për të ndihmuar ekonominë dhe standardet e jetesës së saj.

- Segmentet të tëra të popullsisë shqiptare në Jugosllavi e ndjenin se janë konsideruar si qytetarë të dorës së dytë dhe se nuk kanë të ardhme në shtetin sllav; dhe

- studentët "e papunë" të Universitetit dhe intelektualët që herë pas here ishin në ballë të agjitacionit nationalist, do të ishin veçanërisht dyshues ndaj "komunizmit egalitar" dhe konceptit "një Shqipëri" të Hoxhës.

(C) Dështimi i autoriteteve (d.m.th. federale dhe serbe) për të bërë progres të dukshëm në stabilizimin e "situatës së ndërlikuar" në Kosovë 5 muaj pas shpërthimit të demonstratave studentore nënvizon natyrën e vështirë të problemeve që lidhen me nacionalizmin shqiptar. Për më tepër, tensionet e rritura ndërmjet shqiptarëve, nga njëra anë, dhe serbëve dhe maqedonasve, nga ana tjetër, kanë prodhuar një "reagim të ashpër" nationalist veçanërisht në radhët e serbëve. Ekzistonte njëfarë shqetësimi në mes jugosllavëve dhe një "reagim i tillë i ashpër" mund të acarojë mosmarrëveshjet për kombësinë në përgjithësi dhe mund të dëmtojë rëndë Federatën.

(C) Maturia e jugosllavëve në marrëdhëniet e ardhshme me Shqipërinë

Megjithëse Shqipëria nuk mund të bëhet përgjegjëse për trazirat, zyrtarët jugosllavë duhet të jenë më të kujdesshëm në marrëdhëniet e ardhshme me Tiranën dhe të sigurojnë se shqiptarët në Jugosllavi nuk përbëjnë kërcënim për stabilitetin. Në përballimin e problemeve të lidhura me pakicën e pakënaqur shqiptare dhe Tiranën armiqësore, autoritetet jugosllave do të duhet të tregojnë maturi dhe vetëpërbajtje - qoftë edhe vetëm për të penguar Shqipërinë që të mos kthehet nga sovjetikët, dhe BRSS që të mos bëhet përfutuesi kryesor i pasojave të Kosovës. Fushata intensive anti-shqiptare e propagandës së Beogradit ka shërbyer për të ndezur armiqësitë tradicionale dhe mbase për të bërë të pamundur ndonjë përmirësim të rëndësishëm në marrëdhëniet dypalëshe gjatë kohës që Hoxha është në pushtet. Përpjekjet jugosllave për të minuar Hoxhën do të jenë ndoshta joproduktive për të ardhmen e parashikueshme; ato ka të ngjarë që do të forconin mbështetjen e tij në radhët e popullsisë shqiptare e frikësuar nga "hegemonia" jugosllave dhe mund të bëjnë më tërheqës afrimin me sovjetikët.

Nuk dihet se çfarë efekti, nëse ka ndonjë, ka pasur "brutaliteti" i supozuar jugosllav për shtypjen e trazirave në rritjen e ndjenjës kosovare për t'u bashkuar me Shqipërinë (më shumë se statusin e Republikës jugosllave). Po kështu, askush nuk mund të dallojë nëse brutaliteti ka pasur rol në vendimin e regjimit shqiptar për të vepruar si "protektor" i komunitetit shqiptar në Jugosllavi.



Por Tirana ishte qartazi e gatshme për të rrezikuar marrëdhëniet e saj me Beogradin mbi çështjen e Kosovës.

(C) Vazhdimi i armiqësisë shqiptare

Në propagandën e saj, Tirana shfrytëzoi qëllimisht vështirësitë e regjimit jugosllav me qëllim që të përmirësonte imazhin e saj në radhët e komunitetit etnik shqiptar. Ajo bëri të ditur qëllimin e saj për të kundërshtuar "persekutimet" dhe "përndjekjet" e Beogradit në Kosovë; ajo, gjithashtu, akuzoi se politikën e jashtme dhe të brendshme të Jugosllavisë duhet të kundërshtohen sepse ato ishin "të mbushura me rrezik" për Shqipërinë, vetë Jugosllavinë dhe Ballkanin. Duke pasur parasysh rezistencën pa kompromis të Hoxhës ndaj "revizionizmit" jugosllav, ka të ngjarë që regjimi i Tiranës të braktisë rolin e vet negativ në të ardhmen e afërt. Hoxha dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë mund të jenë bindur se përpjekjet e tyre për të shfrytëzuar problemet politike, ekonomike dhe etnike të Jugosllavisë do të detyrojnë udhëheqësit e Beogradit të përqendrohen në punët e brendshme dhe jo në punët e jashtme, duke e bërë Beogradin një kërcënim shumë më të vogël për Shqipërinë. Propagandistët e Tiranës e kanë karakterizuar situatën e Jugosllavisë si një situatë të "kontradiktave dhe dizintegritimit të thellë kombëtar, politik, ekonomik dhe shtetëror". Nëse shqiptarët aktualisht e ndjenin se regjimi jugosllav rrezikonte të shembej, mund të pritej që ata të organizonin një përpjekje më agresive për të realizuar qëllimin e tyre "Një Shqipëri". Për të arritur këtë, ata mund të bëjnë marrëveshje me sovjetikët – ashtu siç shumë jugosllavë dyshojnë se ata tashmë e kanë bërë një gjë të tillë.

Sidoqoftë, deri tani nuk ka tregues se Hoxha ka bërë ndonjë gjest ndaj Moskës ose se ai ka qenë perceptues ndaj propozimeve sovjetike për përmirësimin e lidhjeve shqiptaro-sovjetike. Që prej trazirave në Kosovë dhe përkeqësimit vijues të marrëdhënieve jugosllavo-

shqiptare, Tirana është përpjekur të përmirësojë marrëdhëniet e saj me vendet e zgjedhura perëndimore dhe të paangazhuara. Marrëveshja e qershorit midis Shqipërisë dhe Italisë për një program shkëmbimi arsimor, kulturor dhe shkencor për vitet 1981-1983, mund të jetë ndikuar nga vendimi jugosllav për të anuluar programet e ndryshme ekzistuese të bashkëpunimit me Shqipërinë. Vlerësimet e brendshme (vështirësitë ekonomike dhe kundërshtimi në rritje ndaj politikave dogmatike dhe izolacioniste) mund të kenë luajtur rol në vendimin e Shqipërisë për të sulmuar politikën e Jugosllavisë. Hoxha mund të ketë pasur dëshirë të përdorte Jugosllavinë si një mjet për të mbledhur popullsinë e tij kundër kërcënimit të jashtëm dhe për pasojë për të minimizuar trazirat e brendshme. Ai gjithashtu mund të ketë qenë i shqetësuar për ndikimin eventual të përpjekjes jugosllave për të përdorur Kosovën si urë dhe "vend tërheqës" për shqiptarët dhe për krahasimet e urryera midis lirive më të mëdha politike, shoqërore dhe ekonomike në Kosovë kundrejt kushteve shtypëse, izolacioniste dhe të prapambetura në Shqipëri (disa mësues të dërguar nga Shqipëria në Kosovë në programet e shkëmbimit thuhet se janë pushuar nga shërbimi apo dëbuar në provinca pas kthimit të tyre – me dyshimin se janë molepsur nga "revizionizmi" jugosllav). Gjithashtu, disa zyrtarë drejtues të spastruar nga Hoxha në vitet 1970, duke përfshirë ish-Ministrin e Mbrojtjes Balluku dhe ish-Kryetarin e Parlamentit Këllezi - të dy bashkëpunëtorë për një kohë të gjatë të Hoxhës - thuhet se kanë pranuar që kanë pasur "lidhje tradhtarë" me "revizionistët" jugosllavë dhe sovjetikë.

(C) Perspektivat Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare kanë pësuar kthim të rëndë prapa; Mund të duhen vite që të ndodhin përmirësime. Ka të ngjarë që të dyja palët të presin me durim duke e parë njëra-tjetrën me mosbesim, por duke shmangur një prishje që mund të

inkurajojë Moskën për t'u bërë më aktive në Ballkan. Zyrtarët jugosllavë e kuptojnë se Tirana ka aftësinë që të nxisë pakënaqësi dhe trazira në radhët e shqiptarëve etnikë. Kështu, zgjidhja e "problemit" shqiptar mbetet vendimtare për integritetin territorial të Jugosllavisë dhe për stabilitetin në Ballkan. Pas ikjes së Hoxhës, mund të rriten perspektivat për përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe, veçanërisht nëse shfaqet një udhëheqje më pragmatike. Megjithatë, një udhëheqje e tillë mund të rrisë tërheqjen e bashkimit me Tiranën për shqiptarët etnikë në kufirin jugosllav - nëse këta udhëheqës nuk kanë minimizuar këndvështrimin nacionalist. Por, udhëheqësit e Tiranës mund të vazhdojnë gjithashtu paragjykimet e forta anti-jugosllave që kanë karakterizuar hierarkinë shqiptare, dhe nga halli të kthehen nga Perëndimi ose, siç ka më shumë të ngjarë, të kthehen nga sovjetikët për ndihmë ekonomike ose mbrojtje kundër Jugosllavisë. Për shumë shqiptarë, Jugosllavia fqinje ka qenë gjithmonë një kërcënim më i madh sesa BRSS e largët.

Përgatitur nga P. Costolanski

Miratur nga M. Mautner

x22876

x29536

-88-

Konfidenciale

Shkresë për Beogradin

GRS 1083

Nga J C R Gray, EESD

Referenca e dosjes, datë 25 gusht '81

Grupi i punës i EC/Evropës Lindore: analizë mbi situatën në Shqipëri

1. Duhet të keni parë në përkujtesën time të datës 7 gusht për Joe Banks se në përgjigje të sugjerimit të Terry Clark për të bërë një analizë mbi zhvillimet e brendshme në Shqipëri, po bëjmë përgatitje që këtë ta marrë përsipër EC/EEWG në mbledhjen e radhës më 16 dhe 17 shtator. Paragrafi 2 deri në 9 më poshtë përbëjnë përpjekjen time të parë për një

draft të tillë ku dhe do të mirëprisja çdo koment apo kritikë nga Beogradi. A mund t'i dërgoni këto komente afërsisht deri të mërkurën më 2 shtator? Nëse mund të arrijnë pas 28 gushtit a mund t'i adresoni tek Bob Campbell, i cili do të grumbullojë komentet në mungesën time ndërkohë që jam me leje gjatë gjysmës së parë të shtatorit?

2. Fillimi i draftit

Hyrje

Në mungesë të Ambasadës Britanike në Tiranë jemi domosdo të keqinformuar për situatën politike në Shqipëri. Për rrjedhojë, qëllimi i këtij dokumenti është që të hedhim në letër atë që dimë me shpresën se partnerët që kanë misionet rezidente në Tiranë, mund të jenë në gjendje të mbushin këto boshllëqe. Do të mirëpritet veçanërisht një analizë e mëtejshme politike.

3. Regjimi shqiptar mbetet regjimi më i rreptë despotik dhe Stalinist në Evropën Lindore. Por që prej Kongresit të fundit në vitin 1976, ka pasur njëfarë zbutjeje në çështje të tilla si kontaktet me të huajt. Kjo politikë mund të jetë mbështetur veçanërisht fort nga Hoxha: por ka sugjerime se mund të ketë qenë më pak e mirëpritur për Shehun. Megjithatë, të dhënat për një divergjencë të tillë janë aq të pakta sa të mos konsiderohet më shumë se thjesht një hipotezë e arsyeshme paraprake.

4. Por, megjithëse kemi pak të dhëna mbi mosmarrëveshjet politike brenda Partisë, ka të dhëna të qarta mbi dallimin mes brezave në organe të ndryshme partiake.

Byroja Politike aktuale e cila u zgjodh në Kongresin e 7-të në vitin 1976, përbëhet nga 11 anëtarë të plotë dhe 5 anëtarë kandidatë. Të gjithë anëtarët e plotë, përveç dy relativisht të posaçdhurve, Hekuran Isai dhe Pali Miska, të cilët u zgjodhën në vitin 1975, i përkasin grupit të periudhës së luftës që është i lidhur ngushtë me Hoxhën dhe është zgjedhur në mënyrë të përsëritur. Por të gjithë, përveç njërit prej anëtarëve kandidatë, janë emëruar që në vitin 1975 dhe i përkasin një brezi të ri që ka marrë dominim të menjëhershëm nën patronazhin e Hoxhës. Një dallim i ngjashëm brezash ekziston në Sekretariatit me 4 anëtarë përfshirë Hoxhën: një, Ramiz Alia, ka qenë anëtar që prej vitit 1960. Por dy të tjerët, Hekuran Isai dhe Prokop Murra, janë emëruar në vitin 1976. Prurja e gjatut të ri është edhe më qartësisht e dukshme në Komitetin Qendror, ku më shumë se gjysma e 77 anëtarëve të tij janë zgjedhur për herë të parë në Kongresin e fundit. Duket e mundshme që shumica e figurave të promovuara rishtazi janë persona të favorizuar nga Hoxha dhe që pasqyrojnë pikëpamjet e tij. Vijimësia

5. Hoxha, Sekretari i Parë i Partisë e ka mbajtur këtë post që në vitin 1948, dhe Shehu, si Kryeministër, që në vitin 1954. Ata janë respektivisht 73 dhe 68 vjeç dhe

thuhet, së paku prej disa vitesh, se Hoxha është i sëmurë rëndë me ankesa të ndryshme përfshirë sëmundjen e kancerit dhe parkinsonit. Dalja e tij e fundit për të cilin jemi në dijeni ishte në ditën e 1 Majit këtë vit kur ai në dukje ishte në formë të mirë. Dëshmi të një vijimësie të mundshme mund të dalin nga Kongresi i 8-të i Partisë që pritet të mbledhet më 1 nëntor. Por, për momentin, besojmë se pasardhësi më i mundshëm do të jetë Shehu dhe Alia do të jetë zgjedhje e dytë.

Ekonomia

6. Shqipëria është ende vendi më i varfër në Evropë dhe tërheqja nga ndihma kineze në vitin 1978 ishte një goditje. Por standardi i jetesës dhe kushtet sociale janë përmirësuar. Aktualisht theksi kryesor në politikën industriale është në elektricitet, kimikate (veçanërisht plehrat kimike) dhe inxhinieri (veçanërisht pjesët rezervë për pajisjet kapitale ekzistuese). Në bujqësi, Shqipëria ka qenë e pavarur në prodhimin e grurit që në vitin 1976 dhe madje ka prodhuar teprica të vogla për eksport. Plani aktual 5-vjeçar (1981-85) synon vazhdimin e rritjes së shpejtë, përsëri pa hua nga jashtë dhe ndihmë ekonomike. Me gjithë sukseset e pretenduara për rritjen e shkallës së ngritjes ekonomike pa ndihmë të huaj, Shqipëria ka të ngjarë ta ketë tejet të vështirë të ruajë rritjen e shpejtë nëse vazhdon me politikën e vetëmjaftueshmërisë së ngurtë.

7. Shqipëria ka disa burime natyrore: naftë që mjafton për të mbuluar një të tretën e nevojave të saj dhe për të lënë një tepriç të vogël për eksport (megjithëse ka cilësi të dobët dhe vështirësi në nxjerrjen e saj), qymyr dhe një potencial të konsiderueshëm hidro-elektrik. Vendi ka gjithashtu burime të rëndësishme minerale hekuri dhe bakri, megjithëse aktualisht prodhimin e bakrit është në një shkallë mjaft të vogël. Burimi më i rëndësishëm i Shqipërisë është kromi, për të cilin ajo është aktualisht prodhuesja e tretë më e madhe në botë dhe eksportuesja e dytë më e madhe. Por ne besojmë se rezervat e vërtetuara janë ndoshta të mjaftueshme për më pak se prodhimin e 10 viteve në normat aktuale dhe përfaqësojnë vetëm rreth 1% të rezervave të përgjithshme botërore; edhe rezervat potenciale ndoshta nuk do të zgjasin më shumë se për 20 vjet të tjera. Shqipëria do të jetë me fat nëse do të ruajë prodhimin e mineralit të kromit në nivelin aktual deri në fund të viteve 1980. Për pasojë, objektivi për zgjerim është i kufizuar. Do të duhet disa kohë për të zgjeruar kapacitetin e prodhimit.

Tregtia e jashtme

8. Qeveria shqiptare ka bërë përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet tregtare me 80 apo më shumë vende me të cilat ajo ka marrëdhënie diplomatike. Por që në fillim të viteve 70, tregtia e jashtme shqiptare nuk është rritur më shumë se 600 milion dollarë

amerikanë në vit. Tregtia me vendet jo-sovjetike Komekon (Comecon) është rreth 200 milion dollarë amerikanë në vit, kryesisht me bazë shkëmbimi. Tregtia me Bashkimin Sovjetik është e papërfillshme. Tregtia me Perëndimin e zhvilluar arrin gjithashtu në rreth 200 milionë dollarë amerikanë. Partneri më i madh tregtar i Shqipërisë tani është Jugosllavia. Kohët e fundit, Shqipëria është përpjekur të inkurajojë partnerët e saj tregtarë përëndimorë që të bëjnë tregti mbi bazën e shkëmbimit ose ndërrimit të mallrave: një gjë e tillë mund të pengojë planet për zgjerimin e këtyre lidhjeve tregtare në të ardhmen e afërt.

9. Balancimi i tregtisë shqiptare midis Lindjes dhe Perëndimit nuk është thjesht rezultat i dëshirës së udhëheqjes për të ruajtur pavarësinë politike të vendit. Pajisjet e avancuara përëndimore do të mbeten jetike për zhvillimin e industrisë shqiptare, por tregjet e Komekon janë më shumë të afta që të tërheqin mallra të prodhuara shqiptare të kualitetit të dobët. Megjithëse Shqipëria ka kapacitetin të shtojë eksportet e saj minerale dhe energjetike, ajo nuk do të jetë në gjendje të importojë të gjitha makineritë që kërkon nga Perëndimi: disa furnizime do të duhet të vijnë nga Evropa Lindore. Nënshkruar nga J C R Gray

-89-

Konfidenciale

C
H E C
DA
Për dijeni: J C R Gray Esq, EESD
P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit

Shqipëria

1. Takova sot Jan Hesseling në Ambasadën holandeze për të diskutuar për Shqipërinë. Personalitetet

2. Ai tha se ishte shumë e vështirë për Misionet në Tiranë për të marrë të dhëna për personalitetet drejtuese në Shqipëri meqenëse nuk janë publikuar madje as detajet bazë të tilla si vendi dhe data e lindjes. Hesseling komentoi se, megjithëse Hoxha është i sëmurë, ai shkruan ende artikujt kryesorë për gazetën "Zëri i Popullit" dhe ruan një kontroll të fortë të çështjeve shtetërore. Ai shfaqet në publik tre herë në vit, më 1 maj, 29 nëntor dhe rasti i tretë është zakonisht kur viziton një fabrikë. Për pjesën tjetër të kohës ai qëndron në shtëpinë e tij, e cila është larg rrugës kryesore në Tiranë dhe vizitohet vetëm nga këshilltarët e tij të afërt. Thuhet se ai asnjëherë nuk i shtrëngon dorën të huajve, por kalon në distancë dhe i përshëndet. Hesseling komenton se kjo sjellje ksenofobike është ndoshta shkaku kryesor i politikës izoluese Shqipërisë. Ai tha se Shehu i pranon letrat kredenciale nga Ambasadorët e rinj dhe, në përgjithësi, vepron si President me Hoxhën që ruan një rol të fortë, por gjithsesi në

sfond.

Çështjet ekonomike

3. Drafti i Planit të ri 5-vjeçar u miratua në fillim të korrikut dhe do të jetë plani i parë sipas të cilit Shqipëria duhet të mbështetet tërësisht në burimet e veta. Ai tha se shqiptarët e kanë pranuar se standardi i jetesës do të bjerë për shkak të Planit, por ata kanë thënë se më parë pranojnë të jenë të varfër dhe të pavarur sesa të varen nga vendet e tjera.

Disidentët

4. Jan Hesseling tha se, sipas jugosllavëve, në Shqipëri ka rreth 1-2,000 të burgosur politikë (një shifër shumë më e ulët se 20,000 që pretendohet nga grekët). Ata zakonisht marrin dënime të rrepta me punë të rëndë dhe mbahen në kampe të veçanta. Të burgosurit nuk mbahen të izoluar por në grupe. Disidentët që janë arratisur thonë se është e vështirë të largohesh nga vendi meqenëse kufijtë (duke përfshirë liqenet) janë të mbrojtur nga dy gardhe me lidhje zinxhirësh rreth 300 metra larg njëri tjetrit. Në kufijtë tokësorë zona ndërmjet gardheve është shtruar me mina tokësore dhe mina anti-personel.

5. Jugosllavët thonë se rreth 1,000 shqiptarë arrijnë të largohen nga vendi çdo vit për në Jugosllavi. Me të arritur aty, ata mbyllën në kampe të veçanta pritëse për rreth tre jave ndërkohë që merren në pyetje. Pjesa më e madhe e tyre marrin azil politik aty dhe vendosen në zonat shqiptare të Maqedonisë, Malit të Zi dhe natyrisht Kosovës. Pjesa tjetër dorëzohet pranë UNHCR që të risistemohen në vende të tjera.

27 gusht 1981

I Juaji

J. Ward

-90-

Konfidenciale

GRS 370
FM Beograd 011400Z shtator '81
Direkt për FCO
Telegram nr. 156, i datës 01 shtator '81

Shkresa e Gray e datës 25 gusht: dokumenti i EC/EEWG mbi situatën në Shqipëri

1. Përshëndes këtë iniciativë për të grumbulluar të dhënat e EC meqenëse është e qartë nga kërkimet e rastësishme këtu se disa nga kolegët tanë kanë shumë informacione në Shqipëri nga vëzhgimet e drejtpërdrejta sesa na janë vënë në dispozicion.

2. Kritika ime kryesore për draftin është se nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë problemin e ngritur në letrën time të datës 12 maj për Brian Fall, konkretisht pasojat për Kosovën dhe Jugosllavinë nga ndryshimi i regjimit në Shqipëri. Mendoj se duhet të përfshini në hyrje, p.sh. pas fjalisë së parë, diçka që të ketë efektin në vijim:

"Interesi ynë është rritur veçanërisht nga deklaratat jugosllave se një prej arsyeve të trazirave të kohëve të fundit në Kosovë ishte se nacionalistët shqiptarë të Kosovës po përgatisnin rrugën për pavarësinë e Kosovës nga Serbia si një hap i parë drejt shkëputjes nga Jugosllavia dhe bashkimit me Shqipërinë. Sidoqoftë, në qarqet përëndimore është arsyetuar se nacionalistët nuk ishin aq shumë të interesuar për t'u bashkuar me Shqipërinë e Enver Hoxhës si një vend nën regjimin e pasuesit në të cilin kosovarët do të luanin një rol drejtues. Të dhënat tona në mbështetje të një spekulimi të tillë janë të pakta, qëllimi i këtij dokumenti është ECT (siç vazhdon drafti juaj)".

3. Nëse pranoni këtë hyrje, nevojitet të përmendni në pjesën kryesore të shkresës lidhjet e mundshme midis shqiptarëve të Kosovës dhe organizatave shqiptare të emigrantëve, për të cilat jugosllavët kanë folur shumë, si dhe lidhjet e këtyre organizatave me shërbimet e fshehta shqiptare/sovjetike/të tjera, për aq sa janë të njohura. Nëse ka një dorë sovjetike që punon në Kosovë, si dëshmi të së cilës kemi vetëm deklaratën enigmatike të Gjukanoviç bërë së fundmi në Athinë dhe deklaratën po aq enigmatike të Vrhovec bërë në Londër, a mund të ketë një lidhje me elementët e pretenduar sovjetikë në Shqipëri? Arsyetimi për këto linja do të çonte në një konkluzion të ngjashëm me atë të JIC(81) (N) 39 të datës 16 korrik, (një version të të cilit kolegët tanë të EC do ta kenë nga NATO?).

4. Në një pikë tjetër më të detajuar në paragrafin tuaj 8, mund të përmendni vizitën e fundit të Bashiç në Tiranë për bisedime tregtare (referuar në shkresën e Jon Ward të datës 12 gusht).

Clark

-91-

Konfidenciale

A. E. Montgomery
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
1 shtator 1981
Inderuar Alan,

Kosova

1. Ju falënderoj për letrën tuaj të datës 12 gusht, ku komentoni mbi njoftimin e Ambasadorit të datës 1 korrik. Mirëpres dialogun për këtë pikë.

Situata e sigurisë

2. Tendenca drejt qetësisë së situatës së sigurisë, që është theksuar në letrën time të datës 28 korrik, duket se vazhdon. Siç shprehet Charles Crawford më vete, shtypi është i mbushur me raporte që tregojnë një qëndrim

të sigurt në drejtim të rihapjes së shkollave më 1 shtator. Në të kundërt, raportet mbi "eksese" të vogla po bëhen gjithnjë e më të rralla. Gjithashtu kam dëgjuar nga Departamenti i Protokollit më 1 shtator se diplomatët kanë marrë aktualisht leje për të vizituar Kosovën si turistë, megjithëse njoftimi tyre nuk është bërë ende meqenëse zyrtarët lokalë janë "tepër të zënë". Do t'ju dërgojmë sa më shpejt informacione mbi studimin e terrenit.

3. Ndërkohë, ekzistojnë raporte mbi diskutime serioze të zhvilluara midis firmave kosovare dhe firmave të tjera jugosllave me qëllim që të krijojnë ndërmarrje të reja në Krahinë. Këto marrëveshje, të njohura në zhargon si "fondet sociale shoqëruese", padyshim do të pasqyrohen në Planin e rishikuar 5-vjeçar për Kosovën që pritet të dalë më vonë gjatë këtij muaji.

4. Megjithëse këto janë të gjitha shenja shpresëdhënëse për rikthimin e statuskuosë mëparshme, jam dakord me konkluzionin tuaj që problemi themelor vazhdon. Dënimet e ashpra që po jepen për udhëheqësit e demonstratave dhe për të tjerë për vepra penale krahasimisht të vogla të tilla si thjesht shkrimi i parullave dhe përjashtimi i studentëve, nxënësve dhe punëtorëve, janë masa të rënda shtypëse, të cilat mund të veprojnë si element frenues në aspektin afatshkurtër, por gjithashtu mund të forcojnë pakënaqësinë e nacionalistëve dhe vendosmërinë e tyre për të rezistuar në aspektin afatgjatë.

5. Një incident i çuditshëm dhe i pashpjeguar deri tani më 24 gusht mund të jetë puna e opozitës. Në orën 10.15 të këtij mëngjesi, linja elektrike që transportonte energji elektrike nga Kosova në Maqedoni, duhej të mbyllej "për shkak të një defekti". Maqedonia ishte pa energji elektrike për një orë e gjysmë derisa u mundësua një lidhje me Greqinë. Për këtë u ngrit një komision i veçantë për hetimin e situatës. Unë arsyetoj se ky rast mund të ketë qenë sabotim.

Nacionalizmi serb

6. Kam reflektuar mbi vëzhgimet tuaja lidhur me efektet anësore të Kosovës për nacionalizmin serb. Natyrisht keni pasur në mendje artikullin e mirë-informuar të Chris Cviç në gazetën 'The Tablet' të datës 8 gusht. Megjithatë, mendoj se vërejtjet e tij mbi marrëdhëniet serbo-maqedonase janë tërësisht spekulim. Është e vërtetë se kontaktet e nivelit të lartë midis autoriteteve dhe Kishës Ortodokse serbe duket se kanë qenë më të shpeshta së fundmi dhe po kështu atmosfera, duke gjykuar nga pasqyrimi i TV, ka qenë më e ngrohtë. Sidoqoftë, kjo situatë nuk ka penguar kritikën zyrtare në shtypin popullor të nacionalistëve klerikë, të cilët përfshinin ortodoksë si dhe

katolikë dhe myslimanë dhe vetëm rreth një javë më parë doli një përgjigje e fuqishme në gazetën "Pravoslavje", e cila është një gazetë ortodokse që del dy herë në muaj. Kështu, e gjithë kjo panoramë nuk është e gjitha e ëmbël dhe e ndriçuar.

7. Përveç kësaj, Cviç është në rrugë të gabuar për kishat serbe dhe maqedonase. Problemi për pajtim nuk premtonte sukses në anën maqedonase. Patriarku serb, German, ka kundërshtuar thekshëm krijimin e Kishës autoqefale maqedonase dhe, sipas të gjitha gjasave, vazhdon të mbajë këtë qëndrim. Natyrisht pakënaqësia e tij mund të jetë e shoqëruar me Kryepeshkopin Dositej, por vdekja e këtij të fundit dhe zëvendësimi i tij më 18 gusht nga Angelarij, ish metropolitani 70-vjeçar i Dibrës dhe Kërçovës, nuk ka të ngjarë që të ndryshojë qëndrimin e Germanit. Dyshoj se pajtimi mund të arrihet vetëm pas vdekjes së Germanit. Por ky mendim është po aq spekulativ sa edhe pikëpamja e Cviçit.

8. Për momentin, nacionalistët e zjarrtë serbë do të vazhdojnë të ankohen për "humbjen" e Maqedonisë dhe nacionalistët e zjarrtë maqedonas padyshim do të vazhdojnë të ndejnë keqardhje për sundimin e mëparshëm serb. Por unë nuk shoh se maqedonasit mund të sulen me armët e tyre thjesht për shkak të trazirave me shqiptarët në krahinë e Tetovës. Maqedonasit duket se e kanë situatën plotësisht nën kontroll atje dhe kanë bërë të qartë se shqiptarët e tyre janë shqiptarë maqedonas dhe do të mbeten të tillë, duan apo s'duan ata. Duket se ata nuk i janë drejtuar Serbisë apo tjetërkujt për ndihmë.


Kushtetuta

9. Siç e thoni edhe ju, zgjidhja kushtetuese nuk ekziston për Kosovën. Nëse ka pasur ndonjë dyshim në këtë drejtim, Vidiq, Kryetar i Kryesisë serbe i ka hedhur poshtë ato në një vizitë në Mitrovicë më 26 gusht, ku përsëriti në një fjalim aty se "sipas Kushtetutës së Federatës, Serbisë dhe Krahinave Autonome të vitit 1974, është përcaktuar statusi autonom i Krahinave, si dhe është përcaktuar plotësisht pjesëmarrja e tyre aktive në arritjen e marrëveshjeve dhe mirëkuptimit midis Republikave, Krahinave dhe Federatës si dhe roli i tyre aktiv në funksionimin e Serbisë në tërësi". Megjithatë, më vonë ai theksoi: "Nevojitet që ne së bashku të çojmë më tej dhe të perfeksionojmë të gjitha aspektet e marrëdhënieve kushtetuese në Republikën tonë. Kushdo që kundërshton në publik shqyrtimin e kësaj teme, është i gabuar". Kjo deklaratë synon të konfirmojë se shqyrtimi i çështjes vazhdon, por më tepër ka të bëjë me objektivin e shtrëngimit të situatës sesa të lehtësimit të saj.

I Juaji

T. J. Crank

Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

FFK-ja fillon pilot-projektin për krijimin e ligave U13 dhe U15 të vajzave



“Epoka e re”

PRISHTINË, 11 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës ka nisur një pilot-projekt të rëndësishëm për futbollin e vajzave në Kosovë, me synim krijimin e ligave U13 dhe U15. Ky është një tjetër hap i rëndësishëm drejt masivizimit të futbollit dhe përfshirjes së vajzave në aktivitetet sportive.

Pilot-projekti ka filluar me zhvillimin e ndeshjeve të xhiros së parë të grupmoshave U13 dhe U15 në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Në këtë projekt janë pjesëmarrëse 13 klube, të cilat kanë shprehur mbështetjen e tyre për këtë nismë të rëndësishme. Në këtë fazë fillestare janë tri grupe: dy me nga katër ekipe dhe një grup me pesë ekipe. Ndeshjet zhvillohen në bazë të sistemi të Bergerit, me pesë xhiro. Pas kësaj faze, fituesit e dy grupeve të para, si dhe fituesi dhe vendi i dytë i grupit të tretë, do të kalojnë në gjysmëfinale.

Valbona Gashi-Uka, shefe e futbollit të

vajzave në FFK, ka theksuar rëndësinë e kësaj nisme për masivizimin e futbollit të vajzave dhe përparimin e tyre në këtë fushë. “Ka filluar turneu i këtij pilot-projekti për grupmoshat U13 dhe U15, i cili mbështetet nga UEFA dhe FIFA. Ne kemi realizuar edhe projekte të tjera në vitet e kaluara që na kanë shërbyer për ta parë gjendjen aktuale të vajzave të kësaj grupmoshe. Interesimi i madh na ka shtyrë të realizojmë projekte të këtij lloji. Andaj, nga 13 klube nga ato që aktualisht marrin pjesë në gara me grupmoshat e tjera, kanë shprehur interesim për t’u përfshirë në këtë turne. Ky është pilot-projekt, i cili do të përfundojë në muajin qershor. Ky projekt është mirëpritur nga klubet dhe do të jetë parapërgatitje për krijimin e ligave U13 dhe U15, që do të fillojnë nga edicioni i ardhshëm”, ka thënë Gashi-Uka.

Ndërsa trajneret e klubeve pjesëmarrëse, Ylberina Berishaj nga KFF “Dukagjini” dhe Florentina Kallaba nga KFF “2 Korriku”, kanë shprehur gëzimin e tyre për këtë

iniciativë, duke theksuar rëndësinë e një lige të dedikuar për vajzat, si dhe mundësinë për zhvillimin e tyre në këtë sport. “Ky projekt është mirëpritur shumë nga KFF ‘Dukagjini’ sepse u jep mundësi zhvillimit vajzave të lindura nga 2009 deri në vitin 2012, për arsye që gjeneratat e lindura në vitet 2011 dhe 2012 nuk kanë të drejtë të paraqiten në Ligën U17 të vajzave dhe ky projekt është shumë i mirë për zhvillimin e tyre”, ka thënë Berishaj.

“Ky turne i organizuar nga FFK-ja është mirëpritur nga vajzat tona sepse kemi pasur nevojë edhe më herët të kemi një ligë, ndërsa me formimin e kësaj lige do të kemi më shumë vajza të përfshira në futboll”, ka thënë Kallaba. Ky pilot-projekt është në përputhje me Strategjinë për Futbollin e Vajzave që u lansua muaj më parë, por edhe me misionin e FFK-së për ta masivizuar futbollin e vajzave në të gjitha grupmoshat. Të gjitha ndeshjet e këtij pilot-projekti zhvillohen në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali çdo dy javë (të mërkurave), ndërsa të gjitha shpenzimet i mbulon FFK-ja.

SHKURT

Federata e Boksit e Kosovës po kërkon selektor të ri për seniorë

Federata e Boksit e Kosovës është vënë në kërkim të selektorit të ri. Musli Zymberi ka qenë ushtrues detyre i selektorit për gjashtë muaj, ndërsa tash institucioni më i lartë i boksit po e kërkon një selektor për periudhë më afatgjatë për seniorët. FboxK-ja e ka publikuar një letër në faqen në “Facebook”, përmes së cilës ka zbuluar hapjen e konkursit për aplikim për selektorë, i cili do të zgjasë nga 11 deri më 21 prill. Shtëpia e boksit e Kosovës i tregoi edhe kushtet që duhet t’i përmbushin aplikuesit dhe detyrat dhe punët e selektorit të ri.

Hysaj do të largohet nga Lazio

Në Itali janë të sigurt, se Elseid Hysaj do të largohet nga Lazio në fund të këtij sezoni. Ndryshimi i stafit teknik, me Tudor në stol, shtyn gjithnjë e më shumë palët drejt një divorci, në një kohë kur trajneri i ri i aplikon një skemë të re. Me Turdor hapësirat për Hysajn janë me pikatore. Largimi i Sarrit nga Lazio, mentori i tij më i madh, është një tjetër arsye që anësori kuqezi të largohet nga kryeqyteti. Ndryshimi i stafit te Lazio është një lajm i keq edhe për Sylvinhon pasi Hysaj pritet të shkojë në Evropian me pak minuta në këmbë.

Chelsea do të largojë 11 futbollistë, përfshirë edhe Bojën

Chelsea pritet të bëjë një revolucion të vërtetë në afatin kalimtar të verës, ku priten të largohen plot 11 futbollistë, sipas medieve të njohura angleze, mes tyre edhe Armando Broja. Sulmuesi kuqezi u largua gjatë janarit në formë huazimi pa asnjë obligim te Fulhami, por në verë Blutë e Londrës janë gati të heqin dorë përfundimisht prej tij. Broja mbetet një lojtar për të cilin interesohen ende shumë klube, një prej tyre është edhe West Ham. Në verë ata mund të jenë destinacioni i duhur për sulmuesin shqiptar. Përcaktues në të ardhmen e Brojës është edhe kërkesa e klubit të Chelseat, që me shumë mundësi do të jetë shumë më e ulët se 50 milionë euro që ishte në janar.

Final 4 i Ligës Ballkanike, Peja dhe Prishtina duan trofeun e kësaj gare

PRISHTINË, 11 PRILL - Edicioni i 16 i Ligës Ballkanike do të përfundojë të dielën. Për herë të parë Qipro do të organizojë Final 4, ku do të përcaktohet kampioni i ri. Në këtë event do të jenë pjesëmarrëse kampionia e Kosovës, Peja dhe ish-dy herë fituesja e Ligës Ballkanike, Siga

Prishtina. Në Final 4 do të marrin pjesë: PAYBL AEL Limassol e Qipros, Peja, Sigal Prishtina dhe Lovcen e Malit të Zi. Të premten do të zhvillohet gjysmëfinalja e parë mes Sigal Prishtinës dhe Lovcen nga ora 17:00 sipas kohës në Kosovë, derisa Peja me vendasit, PAYBL

AEL Limassol nga ora 19:30. Të dielën nga ora 17:00 do të zhvillohet ndeshja për vendin e tretë, derisa finalja nga ora 19:30. Sigal Prishtina e kishte përfunduar këtë garë në vendin e parë me gjashtë fitore e dy humbje, kurse Peja kishte pesë fitore e tri humbje.



Enrique: Gjithçka mbetet e hapur, mund të fitojmë në Barcelonë

PARIS, 11 PRILL - Paris Saint-Germaini u mposht në lojën e parë çerekfinale të Ligës së Kampionëve nga Barcelona (2-3). Kjo ishte një lojë speciale për trajnerin e parisienëve Luis Enrique, i cili kishte luajtur dhe e kishte drejtuar si trajner gjigantin katalunas në të kaluarën. Ai ndihet i

zhgënjyer me humbjen, por është i bindur se Kylian Mbappe me shokë mund të fitojnë në Barcelonë në lojën e kthimit. "Është e qartë se nuk mund të jesh i kënaqur kur humb, por mendoj se e bëmë një lojë të mirë kundër një kundërshtari të shkëlqyer. Na u komplikuja jeta qysh në

fillim, në atë pjesë të lojës nuk kemi luajtur mirë. Më pas shkuam 2-1, shtylla tek 2-2 dhe më pas 2-3 për ta...", ka thënë Enrique. "Loja është e hapur, do të shkojmë në Barcelonë me shumë dëshirë dhe ambicie. Për ne do të jetë si një finale. Kam besim në skuadrën time. Kemi aspekte

pozitive për të provuar që ta përmbysim rezultatin. Duhet gjithmonë të mundohemi ta japim maksimumin në ndeshje të këtij niveli. Jemi në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. E dimë se mund të fitojmë dhe kjo është ajo që do të shkojmë atje për ta bërë", ka shtuar Enrique.



Alonso pasi refuzoi Liverpoolin: Kishte shumë arsye

Liverpooli, 11 prill - Xabi Alonso ka thënë se nuk ishte koha e duhur për t'u larguar nga Bayer Leverkuseni dhe për t'u bërë trajneri i ri i Liverpoolit. Ish-mesfushori i "Reds" ishte lidhur me shumë spekulime që do ta pasojë Jurgen Kloppin, i cili do të largohet nga "Anfield" në verë. Alonso ka impresionuar plotësisht te Leverkuseni, i cili pritet ta fitojë Bundesligën dhe mbetet i pamposhtur në të gjitha garat. Duke pasur parasysh lidhjet e tij me Liverpoolin dhe suksesin në Gjermani, nuk ishte befasi që ai u shfaq si një pasardhës i mundshëm i Kloppit. Megjithatë, ai së fundmi njoftoi se po qëndron në Leverkusen dhe tani ka dhënë më shumë detaje mbi vendimin e tij për të qëndruar në klub. "Kishte shumë arsye. Pas një viti ne po ndërtojmë një ekip. Po ndërtojmë një frymë të madhe këtu. Kishte shumë arsye dhe kaq shumë



lojtarë. Sezoni ka qenë i mrekullueshëm deri më tani. Me siguri duam të vazhdojmë ta kemi këtë gjë së bashku. U ndjeva pjesë e saj. Pas një viti nuk m'u duk koha e duhur dhe kjo është arsyeja pse jam i përkushtuar", ka thënë Alonso. Megjithëse, Alonso la të kuptohet se ai mund të punojë në Premierë Ligë në të ardhmen. "Asnjëherë nuk e dini", ka shtuar ai përmes "The

Guardian" përpara ndeshjes çerekfinale të Ligës së Evropës të Leverkusenis kundër West Hamit të enjten. Me Alonso që tani nuk është më një opsion për vendin e lirë, Liverpooli e ka kthyer vëmendjen drejt Ruben Amorimit. Një vendim përfundimtar ende nuk është marrë, por Liverpooli tashmë po bën hapa për t'u përgatitur për epokën pas Kloppit.

Denveri merr komandën në Perëndim, zhgënjejnë Miami dhe Clippersat

DENVER, 11 PRILL - Denveri fitoi me rezultat 116-107 ndaj Minnesotas në përballjen mes dy skuadrave që kryesonin renditjen në Konferencën e Perëndimit, duke marrë kështu frenat. Një sfidë e komanduar nga skuadra kampione, ku u dallua Jokiqi me 41 pikë e 17 rebounde, më i miri në fushë. Fitoi edhe skuadra e Phoenixit, që falë 37 pikëve të Bookerit, 26 të Bealit e 24 të



Durantit, mundi me rezultat 124-108 Clippersat jashtë fushës. Befasoi edhe ekipi i Dallasit, që mundi me shifrat 111-92 Miamin në fushën e këtij të fundit, ndeshje ku diferencën e bëri Donqiçi, autor i 29 pikëve. Skuadra e Milwaukeees mundi me rezultat 117-99

Orlandon, sfidë e dominuar nga Bucks, ku dyshja Antetokounmpo-Lillard realizoi 59 pikë. Nuk zhgënjeu Oklahoma, që mposhti me rezultat 128-89 San Antonion, ndeshje ku Alexander Shai realizoi 26 pikë, duke qenë lider në fushë për vendast.

REZULTATET

Cleveland - Memphis	110-98
Miami - Dallas	92-111
Brooklyn - Toronto	106-102
Atlanta - Charlotte	114-115
Oklahoma - San Antonio	128-89
Milwaukee - Orlando	117-99
Denver - Minnesota	116-107
Clippers - Phoenix	108-124

Horner: Ja ku do të garojë vitin tjetër Verstappenin

Pas shumë javësh në heshtje, për shkak të skandalit që e përfshiu dhe problemeve që Red Bull pati në garën e Australisë, shefi i makinës austriake Christian Horner ka folur për mediet. Ai ka dhënë një detaj të rëndësishëm në lidhje me të

ardhmen e Max Verstappenit, i shumëpërfolur për të shkuar te Mercedesi. "Max do të qëndrojë me ne. E them këtë gjë me një garanci 100%. Ai nuk do të shkojë në asnjë skuadër tjetër, por do të vazhdojë të garojë me Red Bull

Racing edhe në të ardhmen", u shpreh Chris Horner për "Sky Sports". Një dyshe që ka bërë histori, duke fituar tre tituj kampionë për pilotë e konstruktorë në sezonet e fundit të Formulës 1. Gjithsesi, Horner është

në dilemë për sa i përket pilotit të dytë të Red Bullit, pozicion që aktualisht e mban meksikani Sergio Perez, që këtë sezon ka tri vende të dyta. "Perezi e ka nisur mirë sezonin, por kontrata e tij skadon në fund të këtij viti. Ndaj ne po

konsiderojmë të gjitha mundësitë që ofron merkato për pilotë, duke parë edhe për alternativa. Varet nga Sergio ta ruajë këtë ritëm dhe ta mbajë vendin të Red Bullit. Gjithsesi, vendimi do të merret më vonë", ka deklaruar Horneri.

SHKURT

Tare në bisedime me dy klube angleze

Pas largimit nga Lazio, Igli Tare po vijon me një periudhë pushimi në karrierën e tij. Një nga drejtorët sportivë kryesorë në vitet e fundit në Serinë A është në bisedime me dy klube angleze për një rikthim në ligën më të fortë në botë. Burime të "Panorama Sport" bëjnë me dije se Tare është duke biseduar me pronarët e Tottenhamit dhe Chelseat. "Spurs" afroi pak kohë më parë Johan Lanxh për ta zëvendësuar Fabio Paraticin që u pezullua për dy vjet e gjysmë nga FIFA. Pavarësisht prej këtyre, dëshira e Igli Tares është të qëndrojë në Itali, por në mungesë të një piste konkrete, alternativa mund të jetë edhe Premierë Liga.

50 mijë dollarë nga 'World Athletic', Luiza Gega pretendente për çmimin

Shoqata Botërore e Atletikës, "World Athletic", ka vendosur të akordojë një çek prej 50 mijë dollarësh për të gjithë sportistët që fitojnë një medalje të artë në Olimpiadë, duke nisur nga "Paris 2024". Tanimë fituesit nuk do ta kenë më suksesin vetëm për prestigj, por kjo do të përkthehet në të ardhura konkrete, veç atyre që çdo shtet apo federatë akordon për sportistët e vendeve përkatëse. Luiza Gega, kampionja e tre mijë metrave me pengesa, ka një shans në "Paris 2024" për ta fituar medaljen e artë dhe kështu t'i shtojë zerot në llogari, duke qenë se tanimë Atletika ka vendosur shpërblim për medaljet e arta.

Xavi: Ishte fitore ndaj njërës prej skuadrave më të mira në botë

Barcelona ka shënuar fitore ndaj Paris Saint-Germainit me rezultat 3-2 në mbrëmjen e së mërkurës në kuadër të Ligës së Kampionëve. Pas ndeshjes është deklaruar trajneri i Barçës, Xavi, i cili ka thënë se, pavarësisht rezultatit nga sfida e parë, PSG-ja mbetet favoriti. "Besoj se PSG mbetet favoriti. E kemi ngushtuar diferencën sepse në mbrojtje kemi qenë solidë. Jam shumë krenar sepse ishte një fitore e madhe kundër një prej skuadrave më të mira në botë. Jemi në gjysmë të rrugës", u shpreh Xavi. Ai hodhi lëvdata ndaj Raphinas, i cili realizoi dy gola në këtë takim. Përndryshe, ndeshja e kthimit do të zhvillohet pas një jave.

PSG-ja, gati të paguajë 120 milionë euro për Osimhenin

Napoli është gati t'i thotë lamtumirë Victor Osimhen, i cili me shumë mundësi do të largohet nga Seria A në fund të këtij sezoni. Mediet italiane theksojnë interesimin e fortë të Paris Saint-Germainit për sulmuesin nigerian, i cili, sipas pikëpamjes së parisienëve, duhet ta zëvendësojë Kylian Mbappen me francezin që pritet të largohet në drejtim të Spanjës. Klubi francez është gati të paguajë të gjithë shumën e klauzolës së lirimimit të sulmuesit, vlerësuar në rreth 120 milionë euro. PSG-ja do t'i ofrojë një kontratë katërvjeçare dhe një pagë prej 13 milionë eurosh në sezon Osimhenit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT


SWISS TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lumë's Details

 lumessedetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hysni Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "7 Shtatori".

tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Leonard Nrecaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Gresa Grajqevci shpall të pavlefshme ID-Kartelën e Kolegjit AAB Prishtinë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

